

# EPOKA

# ERE

E përditshme e pavarur  
Viti XXII, nr. 6786  
E martë, 20 dhjetor 2022  
çmimi 0.40 €

## Deri në tetor janë raportuar 2 287 raste të dhunës në familje

FAQE 7



Na ndiqni edhe në:

[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)

facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABRUCH GMBH  
[www.awr-abbruch.de](http://www.awr-abbruch.de)

DHJETË DITË NGA VËNIA E BARRIKADAVE NË VERI | FAQE 4-5

# KURTI: BARRIKADAT NË VERI NUK DO TË TOLEROHEN GJATË



Kryeministri Albin Kurti ka bërë me dije të hënën se KFOR-i ka kërkuar edhe pak kohë prej institucioneve të Kosovës sa i përket largimit të barrikadave në veri. "Padyshim nuk do të mund

të tolerohen shumë gjatë barrikadat e tilla, por mos harroni ajo çfarë po bëjnë strukturat ilegale të Serbisë të shndërruara në banda kriminale tash së fundmi është fillimi i fazës së

fundit të tyre. Shteti kurrë nuk ka qenë më në binarë", ka deklaruar Kurti. Barrikadat janë ngritur në rrugët që çojnë kah vendkalimet kufitare me Serbinë, Jarinjë dhe Bërnjak

## AKTUALE




PESË TË VRARË NGA TË SHTËNAT NË TORONTO F. 3

GJATË KËTIJ VITI 840 USHTARË TË RINJ IU BASHKUAN FSK-së F. 3

KOSOVA DHE MAQEDONIA NËNSHKRUAJNË PLANIN NË FUSHËN E MBROJTJES PËR VITIN 2023 F. 7


## EKONOMI



LINJA E 10 HEKURUDHORE I KONTRIBUON ZHVILLIMIT EKONOMIK DHE SOCIAL F. 8

OPOZITA KËRCËNON SE PROJEKTILIGJI I PAGAVE DHE AI PËR ZYRTARËT PUBLIKË MUND TË PËRFUNDOJË NË KUSHTETUESE F. 8

## KULTURË



RECENSIONI I ABDULLA AZIZIT PËR LIBRIN "USHTRIA ÇLIRIMTARE E KOSOVËS, VLERË KOMBËTARE" F. 6

**JO NË EMRIN TIM!**  
PROTESTË KUNDËR PADREJTËSISË SË GJYKATËS SPECIALE

Ora 14:00  
24 DHJETOR 2022 - E SHTUNË  
SHESHI "ZAHIR PAJAZITI" PRISHTINË

**TË SHTUNËN PROTESTOHET KUNDËR GJYKATËS SPECIALE ME SLOGANIN "JO NË EMRIN TIM!"** | FAQE 3



**POLICIA: NË VERI JANË TË VENDOSURA NËNTË BARRIKADA, SITUATA VAZHDON E NJËJTË** | FAQE 5

**RENOVA**  
Maqedoni  
Xhepçisht - Tetovë  
Gurëz-Ferizaj  
PUTZ  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 755  
+389 44 487 200  
E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)  
Mob: +377 44 501 289

**PRINCESHA**  
GROUP SH.P.K.  
NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
MITROVICË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

**Kolegji BIZNESI**  
[www.kolegji.biznesi.com](http://www.kolegji.biznesi.com)  
info@kolegji.biznesi.com  
030 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERBALKANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A  
DEGA KOSOVË  
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,  
E-mail: [info@sigma-ks.net](mailto:info@sigma-ks.net) | [www.sigma-ks.net](http://www.sigma-ks.net)

**INFINITY**  
Digital Agency  
Endrit Shaqiri  
+38344685122  
Internet Website,  
Marketing...

## Pesë të vrarë nga të shtënat në Toronto

TORONTO, 19 DHJETOR - Pesë persona janë vrarë dhe një tjetër është plagosur të dielën mbrëma gjatë të shtënave në qytetin Toronto të Kanadasë, konfirmoi policia.

I dyshuari është vrarë gjatë shkëmbimit të zjarrit me policinë, tha shefi i policisë, Jim MacSween. Ai tha për mediet se të shtënat ndodhën në një ndërtesë banimi.

Personi i plagosur është dërguar në spital dhe është “në gjendje serioze”, tha policia.

Policia tha se ishte thirrur për t’iu përgjigjur incidentit në orën

19:20, sipas kohës lokale. “Kur oficerët arritën, ata u përballën me një skenë të tmerrshme, ku një numër personash kishin vdekur”, tha MacSween për gazetaret. “Policët hynë në ndërtesë dhe u përballën me situatën. Mund të konfirmoj se një polic ka përdorur armën e zjarrit dhe si rezultat është vrarë edhe sulmuesi”, shtoi ai.

Policia në Kanada tani po heton motivin e kësaj ngjarjeje, nëse ka ndonjë lidhje mes viktimave dhe të dyshuarit. I dyshuari, që nuk është identifikuar, sipas policisë, ishte 73-vjeçar.

Ndërtesa e banimit ku ndodhi sulmi gjendej afër 30 kilometra në veri të Torontos. Sipas autoriteteve, viktimat u gjetën në banesa të ndryshme të ndërtesës.

Kanadaja ka regjistruar një rritje të dhunës me armë zjarri. Në prill të vitit 2020 një person i veshur me rroba të policisë vrau 22 persona në Nova Skoshia. Ky ishte incidenti më i rëndë me armë zjarri në këtë shtet. Po ashtu, në shtator të këtij viti, një person vrau 11 vetë dhe theri me thikë 18 të tjerë në komunitetin indigjen të Saskatçuanit.



## Ukraina thotë se Rusia përdori dronë kamikazë të Iranit në sulmin në Kiev



KIEV, 19 DHJETOR - Autoritetet ukrainase thanë se Rusia sulmoi rrjetin elektrik dhe infrastrukturën tjetër duke përdorur dronë kamikazë në sulmin e hershëm të mëngjesit në Kiev dhe zonat përreth.

Raportimet fillestare thonë se nuk ka të vdekur, por dy persona u plagosën në sulmin e 19 dhjetorit, për të cilin administrata ushtarake për rajonin e Kievit tha se Moska përdori më shumë se 20 dronë të Iranit.

Zyrtarët ukrainas thanë se sistemet e mbrojtjes ajrore rrëzuan rreth 15 dronë.

Shpërthimet janë dëgjuar pak kohë pas lëshimit të sirenavë paralajmëruese për sulme ajrore. Oleskiy Kuleba, guvernatori i rajonit të Kievit, tha se infrastruktura dhe shtëpitë private u dëmtuan nga sulmet dhe se dy persona u plagosën. “Vendi terrorist vazhdon luftën e tij kundër popullsisë civile”, tha ai në një postim për “Telegram”. “Ne do të kapërcejmë gjithçka”.

Gati 10 muaj pas pushtimit të Ukrainës, Rusia ka përdorur raketa lundrimi dhe dronë të prodhuar nga Irani për ta goditur infrastrukturën energjetike të Ukrainës në mbarë vendin, si pjesë e një strategjie të dukshme për t’i lënë ukrainasit në të ftohtë dhe ta demoralizojë popullsinë.

Javën e kaluar Rusia lëshoi një breshëri raketash dhe dronësh kundër Kievit dhe qyteteve të tjera të Ukrainës, duke shkaktuar ndërprerje të gjera të energjisë.

Ukraina e ka akuzuar Iranin se po e furnizon Rusinë me dronë kamikazë. Teherani fillimisht kishte mohuar këto akuza.

Më vonë Irani pranoi se i ka dërguar Moskës një numër të kufizuar të dronëve “shumë muaj” para se të niste lufta më 24 shkurt. Në përgjigje, presidenti ukrainas Volodymyr Zelensky ka thënë se këto janë gënjeshtër dhe se shumë dronë iraniane po përdoren për ta sulmuar shtetin e tij.

## Fundoset anija e marinës tajlandeze, bllokohen mbi 100 marinarë

BANGKOK, 19 DHJETOR - Një anije detare tajlandeze u përmbys gjatë një stuhie në Gjirin e Tajlandës të dielën mbrëma, duke bllokuar kështu më shumë se 100 marinarë. Sipas autoriteteve tajlandeze, 75 anëtarë të ekuipazhit janë tërhequr, por kanë mbetur edhe 31 marinarë të bllokuar, pasi HTMAS Sukhotai u fundos.

Nuk raportohet për viktima, por pesë anëtarë të ekuipazhit janë në gjendje kritike.

Zyrtarët thanë se anija u fundos pasi i hyri uji, i cili përmbysi trupin e saj.

HTMAS Sukhotai u fundos rreth orës 23:30 me kohën lokale të

dielën. “Kanë kaluar më shumë se 12 orë, por ne do të vazhdojmë të kërkojmë”, tha një zëdhënës i marinës për BBC-në.

Ekipet e kërkimit punuan gjatë gjithë natës për t’i gjetur të mbijetuarit, me operacionin që vazhdoi dhe të hënën, me ndihmën e forcave ajrore. Marina tha se do të hetohet shkaku i fundosjes. “Kjo pothuajse nuk ka ndodhur kurrë në historinë e forcës sonë, veçanërisht me një anije që është ende në përdorim aktiv”, tha zëdhënësi, admiral Pogkrong Monthardpalin.

Gjatë operacionit, 75 nga 106 marinarët në bordin e Sukhotai

shpëtuan, por 31 nga ta janë ende “në ujë”, thuhet në njoftimin për medie të marinës.

Tri anije detare dhe helikopterë u dërguan për ta ndihmuar HTMAS Sukhotai, por vetëm njëra arriti në anije përpara se të fundoset, por ende nuk janë publikuar detaje të tjera.

Kryeministri tajlandez Prayut Chan-o-Cha, në një deklaratë dhënë të hënën, tha se zyrtarët janë duke e hetuar rastin. “Po i ndjek me vëmendje lajmet - rreth pesë persona janë lënduar rëndë”, tha ai. HTMAS Sukhotai u ndërtua për marinën tajlandeze në ShBA në mesin e viteve 1980.



Botohet nga “Epoka e re” • Kryeredaktor: Mal QORRAJ

• Drejtor i përgjithshëm: Sadik ZEQRIRI (Tel: 044 127 434, dhe 049 127 434 e-mail: sadikzeqiri@yahoo.com)

• ADRESA: Prishtinë, përballë ish-Selisë Qendrore të UNMIK-ut

• Tel: 038/227-557, e-mail: epokaere\_mm@hotmail.com & mm\_epokaere@yahoo.com

# Të shtunën protestohet kundër Gjykatës Speciale me sloganin "Jo në emrin tim!"

EPOKA  
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 19 DHJETOR - Të premten e javës së kaluar, Dhomat e Specializuara shqiptuan dënim ndaj ish-komandantit të UÇK-së, Salih Mustafa. Ky vendim për PSD-në, e cila drejtohet nga Dardan Molliqaj, është jashtëzakonisht shqetësues dhe alarmues. "Gjykatat që sjellin padrejtësi duhet t'i kundërshtojmë fuqishëm sepse ato nuk flasin në emër të popullit të Kosovës. Prandaj ftojmë çdonjërin e çdokënd, që të shtunën, më 24 dhjetor, nga ora 14:00, në sheshin "Zahir Pajaziti" të protestojmë njëzëri kundër padrejtësisë së Gjykatës Speciale", ka thënë Molliqaj.

Ai ka thënë se ligji nën të cilin po operojnë Dhomat e Specializuara nuk përkon me frymën universale të të drejtave të njeriut e, në disa raste, tashmë të dokumentuara nga raportime të ndryshme, së fundmi edhe nga Avokati i Popullit, ka shkelur në mënyrë flagrante ato drejta.



"Për neve dy rrugë janë të qarta sesi duhet të veprohet; Së pari, nevojitet urgjentisht të amadamentohet ligji për Dhomat e Specializuara ashtu që nenet më problematike të ndryshohen e kjo gjykatë të shndërrohet në trup

gjykues që sjell drejtësi. Kështu siç është, ajo riprodhon padrejtësi në një rën anë dhe shtrembëron historinë e luftës çliruese të UÇK-së në anën tjetër. Së dyti, vendimet e veprimet e kësaj gjykate, nga arrestimet e krerëve



të UÇK-së e gjerë te deklaratat e udhëheqësve të kësaj gjykate, kanë qenë politike. Si të tilla, së bashku me mënyrën sesi u shqiptua dënimi për z. Mustafa, tregojnë qartazi tendencën që kjo gjykatë ka; tjetërsimin e luftës

çliruese të UÇK-së. Me bazën ligjore nën të cilën vepron, me tendencën politike që ka, kjo gjykatë nuk mund të sjellë drejtësi për askënd e as nuk mund të flas në emër të popullit të Kosovës", ka thënë Molliqaj.

## Gjatë këtij viti 840 ushtarë të rinj iu bashkuan FSK-së

EPOKA  
ERE

Mal QORRAJ

PRISHTINË, 19 DHJETOR - Ministri i Mbrojtjes, Armend Mehaj, ka raportuar të hënën në Komisionin për Çështje të Sigurisë dhe Mbrojtjes, lidhur me raportin vjetor të punës për vitin 2022. Mehaj gjatë prezantimit të tij lidhur me aktivitetet e tyre gjatë vitit 2022 dhe për të arriturat kryesore, ka theksuar se përmbushja e këtyre objektivave padyshim se ka të bëjë edhe me ndarjen e buxhetit, që për vitin 2022 ishte në vlerë prej 102.3 milionë eurosh, apo 35 për qind, vlerë më e lartë sesa në vitin paraprak. Duke falënderuar me këtë rast komisionin për mbështetjen, ministri Mehaj ka thënë se më shumë buxhet për ministrinë do të thotë shumë më shumë siguri për qytetarët tanë dhe më shumë investime në burrat e gratë që bartin uniformën e ushtrisë.

Më tutje, ai ka folur edhe lidhur me avancimin që është bërë në fushën e legjislacionit, duke përmendur



kështu plotësim-ndryshimin e tri ligjeve për Ministrinë e Mbrojtjes dhe FSK-në.

Mehaj ka vlerësuar se me ndryshimin e këtyre ligjeve është bërë një hap i rëndësishëm për

ushtrinë e Republikës së Kosovës. Ndërsa duke përmendur edhe hartimin e ligjit për komisionarin dhe atë për policinë ushtarake, Mehaj ka potencuar se tashmë është krijuar baza e duhur ligjore.

Ai ka njoftuar se gjatë vitit 2022 janë rekrutuar 840 ushtarë të rinj dhe se kanë hartuar edhe strategjinë e sigurisë.

Ai, po ashtu, ka folur edhe për pjesëmarrjen e Kosovës në

"Defender 2023".

Gjatë fjalës së tij para komisionit, Mehaj ka shtuar se synim mbetet anëtarësimi në NATO. "Synimi ynë është anëtarësimi në NATO dhe ofrimi i kontributit tonë si shtet në sigurinë e rajonit dhe më gjerë, me pjesëmarrje në misione ndërkombëtare", ka thënë ai, duke përmendur edhe faktin se janë duke u angazhuar që si lëndë shkollore nëpër shkollat të jetë Edukimi për Siguri, në mënyrë që të inkurajohen të rinjtë e Kosovës t'i bashkohen ushtrisë.

Anëtarët e Komisionit: Mefail Bajqinovci, Arbër Rexhaj, Enver Dugolli, Rashit Qalaj, Anton Quni, Fatmir Humolli e Erxhan Galushi kërkuan sqarime shtesë nga ministri Mehaj. Me theks të veçantë ata kërkuan informata lidhur me vlerën e blerjes së armatimit, rastet e sukseseve të kadetëve, lidhur me çështjen e shërbimit të obligueshëm ushtarak, numrin e pjesëtarëve të FSK-së të cilët kanë lëshuar FSK-në, lidhur me çështjen e komuniteteve të tjera në FSK, projektet kapitale, gradimet etj.

## Dendias telefonon Lajçakun, flasin për zhvillimet e fundit në veri

PRISHTINË, 19 DHJETOR - Ministri i Punëve të Jashtme i Greqisë, Nikos Dendias, ka nisur një vizitë në vendet e Ballkanit Perëndimor. Dendias ka bërë me dije se në kuadër të kësaj vizite ai ka pasur një bisedë me emisarin e BE-së për dialogun

Kosovë - Serbi, Miroslav Lajçak.

Ministri grek ka thënë se me Lajçakun ka biseduar për përpjekjet e ndërmarra për uljen e tensioneve në veri të Kosovës. "Në funksion të vizitave të mia në Ballkanin

Perëndimor këtë javë, pata një bisedë telefonike më parë me emisarin Miroslav Lajçak mbi dialogun Beograd - Prishtinë dhe përpjekjet e ndërmarra për uljen e tensioneve në veri të Kosovës", ka shkruar Dendias në "Twitter".






Foto: Zyra e Kryeministrit të Kosovës

DHJETË DITË NGA VËNIA E BARRIKADAVE NË VERI

# Kurti: Barrikadat në veri nuk do të tolerohen gjatë

Kryeministri Albin Kurti ka bërë me dije të hënën se KFOR-i ka kërkuar edhe pak kohë prej institucioneve të Kosovës sa i përket largimit të barrikadave në veri. “Padyshim nuk do të mund të tolerohen shumë gjatë barrikada të tilla, por mos harroni ajo çfarë po bëjnë strukturat ilegale të Serbisë të shndërruara në banda kriminale tash së fundmi është fillimi i fazës së fundit të tyre. Shteti kurrë nuk ka qenë më në binarë”, ka deklaruar Kurti. Barrikadat janë ngritur në rrugët që çojnë kah vendkalimet kufitare me Serbinë, Jarinjë dhe Bërnjak

javë, nga dita e hënë janë në klasa, por me orë të shkurtuara në 30 minuta.

Nxënësit e shkollave të mesme do t'i ndjekin mësimet online.

Në veri të Mitrovicës është qetë, ndërsa vërehen patrullime të pjesëtarëve të misionit të NATO-s, KFOR, dhe të misionit evropian, EULEX.

KFOR-i ka njoftuar se ka dërguar

trupa shtesë dhe patrulla në veri të Kosovës. “Ne po e monitorojmë nga afër situatën në veri të Kosovës. KFOR-i ka aftësi dhe personel për të ofruar mjedis të sigurt dhe liri të lëvizjes për të gjitha komunitetet në bazë të mandatit tonë që rrjedh nga Rezoluta 1244 e Këshillit të Sigurimit të OKB-së”, ka njoftuar KFOR-i përmes një reagimi.

KFOR-i ka theksuar se rritja e pranisë ushtarake ka nisur që nga muaji tetor.

Misioni paqeruajtës i NATO-s pret që të gjitha palët të koordinohen nga afër me këtë mision dhe të përmbahen “nga shfaqjet provokuese të forcës”. “Ne u bëjmë thirrje të gjitha palëve që të angazhohen në mënyrë konstruktive për të ofruar siguri dhe liri të lëvizjes në Kosovë. Zgjidhja duhet të gjendet përmes dialogut”, u tha në reagimin e KFOR-it.

Pjesëtarët e Policisë së Kosovës janë të vendosur në pjesët multietnike të Mitrovicës së Veriut, si Mëhalla e Boshnjakëve dhe Tre Rrokaqiejt. Në sportelet e bankave që funksionojnë nën sistemin e Serbisë ka para, ndërsa disa bankomate nuk janë në funksion, ose nuk janë rimbushur me para. Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Glauk Konjufca, duke folur për situatën e fundit në veri, ka theksuar se veprimet e Serbisë janë të papranueshme, se ato kanë për qëllim destabilizimin dhe ndarjen de-fakto të shtetit të Kosovës. “Ne si popull qëndrojmë shumë të bashkuar që t'i luftojmë këto veprime të cilat kanë si prapavijë gjeopolitike ndikimin

**EPOKA  
ERE****Mal QORRAJ**

**PRISHTINË, 18 DHJETOR** - Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka thënë të hënën se nuk do të lejohet që barrikadat në veri të qëndrojnë edhe shumë gjatë dhe se për këtë temë janë në koordinim të rregullt me KFOR-in. “KFOR-i ka kërkuar edhe pak kohë prej neve, pra ne jemi në koordinim, në komunikim të rregullt të vazhdueshëm intensiv me KFOR-i dhe padyshim nuk do të mund të tolerohen shumë gjatë barrikadat e tilla, por mos harroni ajo çfarë po bëjnë strukturat ilegale të Serbisë të shndërruara në banda kriminale tash së fundmi

është fillimi i fazës së fundit të tyre. Shteti kurrë nuk ka qenë më në binarë”, ka thënë Kurti.

Për të dhjetën ditë me radhë, grupe serbësh në veri të Kosovës janë duke bllokuar rrugët në shenjë kundërshtimi ndaj arrestimit të ish-policit serb Dejan Pantiq.

Në barrikada e kanë për obligim të qëndrojnë edhe punonjësit e institucioneve publike që funksionojnë nën sistemin e Serbisë. I ashtuquajtur shtab i krizës paralajmëroi për sot kremtimin e festës ortodokse të Shën Nikollës të barrikadat në fshatin Rudarë.

Nxënësit e shkollave fillore, pas ndërprerjes së mësimet për një

## Bislimi: Ka pasur plan ruso-serb që të digjej pika kufitare e Jarinjës

Zëvendëskryeministri i Kosovës, Besnik Bislimi, ka thënë se ka pasur “plan ruso-serb” që të dielën, më 18 dhjetor, të digjej pika kufitare e Jarinjës, që lidh Kosovën me Serbinë. Sipas Bislimit, nga të dhënat e institucioneve të sigurisë del se “autori i vërtetë” i ngjarjeve në Jarinjë ishte presidenti rus Vladimir Putin. Ai tha se plani për djegien e pikës kufitare u parandalua nga institucionet e sigurisë së Kosovës në bashkëpunim “me partnerët perëndimorë, veçmas amerikanët”.

Në anën serbe të Jarinjës, më 18 dhjetor është mbajtur një protestë e thirrur nga grupet djathtëse serbe, në shenjë mbështetjeje ndaj barrikadave që disa serbë lokalë kanë ngritur në veri të Kosovës që nga 10 dhjetori. “Pavarësisht se policia e Serbisë dje u shfaq duke i ndaluar huliganët që mos ta djegin Jarinjën, ky quhet vetëm një akt tërheqjeje nga ana serbe, duke e parë se një gjë e tillë do t'u dështonte”, ka shkruar Bislimi në “Facebook”.

# Policia: Në veri janë të vendosura nëntë barrikada, situata vazhdon e njëjtë

PRISHTINË, 19 DHJETOR - "Forcimi i rendit dhe sigurisë publike, parandalimi i akteve kriminale si dhe ndërmarrja e masave policore konform situatës dhe zhvillimeve në gjithë vendin, përfshirë zhvillimet në veri të vendit, mbesin ndër prioritetet e Policisë së Kosovës", kështu është thënë në një komunikatë të policisë. Sipas Policisë së Kosovës, që nga vendosja e nëntë barrikadave nga

persona/grupe kriminale, situata e sigurisë në veri të vendit vazhdon të jetë e njëjtë ku si pasojë e këtyre barrikadave dy pikat kufitare "Jarinje" dhe "Bërnjak" ende mbesin të mbyllura për qarkullim. "Referuar situatës së krijuar, bllokimit të rrugëve e rasteve/sulmeve të ndodhura nga grupet kriminale, kanë bërë që të krijohen rrethana të reja të punës e, po ashtu, kanë ndikuar edhe në

jetën e qytetarëve të asaj zone, të cilët nuk po mund të kenë lëvizje të lirë si dhe nuk po e kanë qasjen e lehtë në shërbimet e tyre të nevojshme. Edhe përkundër këtyre rrethanave të krijuara në veri të vendit, Policia e Kosovës po angazhohet me të gjitha format që t'u dalë në ndihmë kërkesave dhe nevojave të qytetarëve pa dallime si dhe të punojë në parandalimin e akteve kriminale të cilat po organizohen nga

persona të përfshirë në grupe kriminale të organizuara nga brenda dhe jashtë Kosovës", është thënë në komunikatën e Policisë së Kosovës. Në këtë drejtim, bazuar në informacionet që ka, Policia e Kosovës ka njoftuar se është duke bashkëpunuar ngushtë me institucionet relevante të sigurisë për ndërmarrjen e masave të nevojshme ligjore në interes të ruajtjes së rendit kushtetues të

RKS-së, mundësimin të lëvizjes së lirë dhe sjelljes para organeve të drejtësisë të personave të dyshuar. "Policia e Kosovës vazhdon të jetë e mirëpritur nga qytetarët në nivel vendi, përfshirë edhe banorët në veri të vendit, të cilët bashkëpunojnë me njësitet policore, që ofrojnë siguri dhe shërbime policore për qytetarët pa dallime", është thënë në komunikatën e Policisë së Kosovës.



rus dhe fuqishëm do të ecim në shtetin demokratik të Kosovës për sundim të ligjit dhe për demokraci në tërë territorin e Republikës së Kosovës", është shprehur Konjufca, duke shtuar se nuk do të lejojnë që Vuçiçi përmes bandave kriminale të komandojë në Kosovë.

I dërguari i Bashkimit Evropian për dialogun Kosovë - Serbi, Miroslav Lajçak, gjatë vizitës së tij të fundit në Prishtinë, ka thënë se pëlqen rrugën diplomatike për heqjen e barrikadave në veri dhe jo përmes buldozerëve. "Kam pasur

diskutim të gjatë me [kryeministrin e Kosovës, Albin] Kurti. Nuk do t'i bëj publike detajet, sepse jam në mes të misionit dhe do të tentojmë t'i gjejmë zgjidhjet e mundshme, sepse kjo gjë nuk është e mirë. Unë nuk mendoj se kemi llogari që të presim për të ndodhur diçka e keqe. Tensionet nuk i ndihmojnë askujt dhe nuk mendoj që ndonjë njeri normal është i lumtur me këtë situatë në veri", ka thënë Escobar.

Kurse i dërguari i Shteteve të Bashkuara për Ballkanin

Perëndimor, Gabriel Escobar, ka thënë se pret që barrikatat të hiqen nga personat që i kanë ngritur ato. Situata e sigurisë në veriun e Kosovës, të banuar me shumicë serbe, është tensionuar ditët e fundit, pasi që nga 6 dhjetori janë regjistruar disa incidente me armë zjarri, granata dore dhe shok bomba.

Policia e Kosovës ka arrestuar më 10 dhjetor ish-policin serb Dejan Pantiq, nën akuzat se ka marrë pjesë në sulme kundër zyrtarëve të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve në veri.

Si përgjigje, grupe serbesh në veri kanë ngritur barrikada.

Sulmet, për të cilat akuzohet Pantiq, kanë ndodhur derisa KQZ-ja po përgatitej për zgjedhjet lokale në veri - fillimisht të parapara për 18 dhjetor, por që më pas janë shtyrë për në prill të vitit të ardhshëm.

Komunat në veri kanë mbetur pa kryetarë qysh në fillim të nëntorit, pasi ata kanë dhënë dorëheqje në shenjë kundërshtimi ndaj një vendimi të Qeverisë së Kosovës për t'i reregjistruar makinat me targa të

paligjshme serbe.

Dorëheqje nga institucionet e Kosovës kanë dhënë edhe zyrtarë të tjerë serbë nga veriu.

Më 15 dhjetor Serbia i është drejtuar KFOR-it me kërkesën për dislokimin e deri 1 000 trupave ushtarake dhe policore serbe në Kosovë.

Që nga shpallja e pavarësisë së Kosovës në vitin 2008, grupe të serbëve lokalë në veri të vendit kanë ngritur disa herë barrikada për të kundërshtuar aksione policore dhe vendime të Qeverisë së Kosovës.

# Recension i Abdulla Azizit për librin 'Ushtria Çlirimtare e Kosovës, vlerë kombëtare'

Të nderuar të pranishëm,

Kumtesat nga sesioni shkencor "Ushtria Çlirimtare e Kosovës, vlerë kombëtare", ku janë paraqitur 23 autorë shqiptarë nga të gjitha trojet shqiptare, me punimet e tyre, secili në formën e vet, patën një objektivi të përgjithshëm dhe të pakontestueshëm "mbrojtjen shkencore të vlerës më të rëndësishme kombëtare të shqiptarëve, luftën e drejtë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës". Duke lexuar kumtesat brenda këtyre kopertinave të librit, ajo çka të bie në sy është gjetja e fjalëve kyçe. Secili nga autorët mund ta gjejë veten në fjalët kyçe të cilat do t'i lexojë:

- Fazat e veprimit të UÇK-së;
  - Organizimi i UÇK-së;
  - Konferenca e Rambujesë;
  - Rruga e nderit dhe dinjitetit;
  - Faktori ndërkombëtar;
  - Roli i UÇK-së në shtetformim;
  - Pritja e refugjatëve në Shqipëri;
  - Përmasa kombëtare e luftës;
  - Lufta e madhe e një populli të vogël;
  - Roli i diplomacisë;
  - Gjurmët e luftës së UÇK-së në arkivat;
  - Mbështetja e Shqipërisë dhënë UÇK-së;
  - Kundërshtimet ndaj UÇK-së;
  - Dëshmorët nga Maqedonia e Veriut;
  - Bashkëpunimi me NATO-n;
  - UÇK-ja në letërsi dhe në këngët popullore;
  - Shkëmbimi i robërve të luftës etj.
- Secili nga autorët, nga këndi i fushëveprimit të tij profesional, ka dhënë një kontribut madhështor në përshkrimin e veprimtarisë së UÇK-së si vlerë e popullit kosovar, e mbështetur nga vëllezërit e tyre në Shqipëri dhe Maqedoninë e Veriut si dhe nga viset e tjera shqiptare.

UÇK-ja në historinë e popullit shqiptar karakterizohet me disa vlera të veçanta si: -ushtri mbarëkombëtare e të gjithë shqiptarëve në rajon dhe anembanë botës; - ushtri që në krahët e se cilës radhiten edhe

vullnetarë nga shtetet mike të Kosovës; - ushtri revolucionare që me gjakun e saj çliroi popullin e vet nga pushtuesi sllav; - ushtri 5-fish me e vogël përballë armikut me armatim të sofistikuar dhe teknikë luftarake; - trimëria dhe heroizmi i pashoq i ushtarëve të UÇK-së, morali i tyre i lartë si dhe disiplina ushtarake.

Botimi të cilën e keni në duar paraqet një kontribut të rëndësishëm akademik për audiencën kosovare dhe më gjerë. Autorët këtu bëjnë një analizë të thelluar të veprimtarisë së UÇK-së, nxjerrin konkluzat me bazë shkencore për retrospektivën historike të ngjarjeve dhe ndodhive reale, duke përgënjeshtruar të pavërtetat dhe trillimet për zbehjen e idealit kombëtar të UÇK-së.

Rëndësia e këtij botimi del në pah duke parë vëmendjen në rritje që po i kushtohet aktivitetit shtetformues të UÇK-së në etablimin e një shteti sovran, si subjekt i barabartë në komunitetin ndërkombëtar dhe në marrëdhëniet me vendet tjera. Ky tekst bëhet i rëndësishëm si në kuadrin e një vlere të shtuar për historinë e shtetformimit të Kosovës po ashtu edhe në studimet e bashkëkohore në marrëdhëniet ndërkombëtare dhe sigurinë ndërkombëtare në mjedisin akademik shqiptar.

Autorët me një seriozitet shkencor trajtojnë rëndësinë dhe kontributin e UÇK-së si lëvizje çlirimtare popullore që ka kontribuar në sistemin e sigurinë ndërkombëtare rajonale, veçanërisht kur komuniteti ndërkombëtar kishte toleruar gjatë kohe pushtimin dhe gjenocidin mbi popullin autokton kosovar në trojet e veta. Aq më tepër në një periudhë kur një pjesë e madhe e shteteve në komunitetin ndërkombëtar mbanin në konsideratë interesat miqësore me sllavët, në dëm të drejtave elementare njerëzore të shqiptarëve.

Po ashtu, autorë brenda këtij



botimi potencojnë dështimin e rolit të Këshillit të Sigurimit të OKB-së, si organi kryesor për ruajtjen e paqes dhe sigurisë ndërkombëtare, dhe pakujdesinë e tij për mbrojtje të vlerave civilizuese ndërkombëtare dhe të sigurisë kolektive për shkak të mungesës së konsensusit nga shtetet anëtare të përhershme të Këshillit të Sigurimit.

Po ashtu edhe dilemat rreth lejueshmërisë në dispozitat e Kartës së OKB-së, zakonisht ndërkombëtar si dhe praktikës së kombeve të qytetëruara të cilat e arsyetojnë praktikën e ndërhyrjes humanitare. Në këtë kontekst, është analizuar intervenimi humanitar në Kosovë, duke

paraqitur argumente pro një intervenim te domosdoshëm ne rrethanat e asaj kohe. Me një mprehtësi shtjellohen sfidat me të cilat u ballafaqua shteti i Kosovës përpara periudhës së intervenimit humanitar dhe shkeljet e te drejtave themelore njerëzore të garantuara nga e drejta ndërkombëtare si ius cogens. Duke u bazuar në tërësinë e instrumenteve juridike të karakterit ndërkombëtar, autorët japin një qasje komparative shkencore edhe rasteve tjera lidhur me intervenimin humanitar. Këtu konstatohet se intervenimi humanitar në Kosovë ishte i domosdoshëm (edhe përtej mungesës së një Rezolute nga Këshilli i Sigurimit i OKB-së), ashtu siç kanë konstatuar shumë kohë më parë autorë të shquar të së drejtës ndërkombëtare dhe zyrtarë të lartë nga bashkësia ndërkombëtare.

Ky botim posedon referenca dhe burime të rëndësishme nga autorë ndërkombëtar e vendor, ndërsa ajo që vlen të veçohet është se autorët në asnjë rast nuk bien nën ndikimin e vlerësimeve tjera paraprake, por përkundrazi ndërtojnë një qasje individuale të mbështetur përmes një analize të thelluar të fakteve.

Po ashtu, në mënyrë të detajuar në brendi të këtij botimi potencohen dështimet dhe sukseset e deritanishme të sistemit ndërkombëtar të sigurisë, madje sugjeron edhe reforma përmes të cilave do të ishin evituar mangësitë, ndërsa OKB do të bëhej më efektive dhe më funksionale në garantimin e sigurisë ndërkombëtare. Anëtarët

e Këshillit të Sigurimit, pranë OKB-së kanë interesa dhe vlerësime të ndryshme rreth natyrës dhe karakterit të rreziqeve e kërcënimeve ndaj paqes dhe sigurisë në botë, si dhe mospranimin e masave ndëshkuese ndaj shteteve apo aktorëve që shkelin kërkesat e Kartës së OKB-së. Kjo bën që shtetet ta kenë më lehtë mosndërmarrjen e aksioneve për sigurimin e paqes nëse shkeljet i bën ndonjë shtet i fuqishëm apo aleat i tij.

Përpjekjet më serioze e parandalimit dhe ndalimit të konflikteve dhe ndërimitin e paqes dhe sigurisë ndërkombëtare mund të bëhen vetëm përmes një OKB-je të reformuar dhe moderuar. Me të drejtë konstatohet se Kombet e Bashkuara janë dhe mbeten autoriteti më i lartë i sistemit të sigurisë kolektive në shkallë globale.

Duke u bazuar në argumentet e lartpërmendura, fuqishëm e përkrah botimin e kumtesave, ndërsa kontributi i autoreve nga profili i një intelektualit është shumë domethënëse për popullin shqiptar në Kosovë dhe më gjerë, ndërsa ky tekst do t'u shërben jo vetëm studentëve dhe profesorëve, por edhe të gjithë të interesuarve të tjerë si studiues të cilët do të merren me këtë problematikë, zyrtarë në institucionet qeveritare apo joqeveritare, si dhe lexuesit në përgjithësi.

(Abdulla Azizi, dekan i Fakultetit të Shkencave Shoqërore Bashkëkohore të Universitetit të Evropës Juglindore - Tetovë)



## Kosova dhe Maqedonia nënshkruajnë planin në fushën e mbrojtjes për vitin 2023

PRISHTINË, 19 DHJETOR - Pas një pune të përbashkët në mes dy delegacioneve, në Ministrinë e Mbrojtjes të Republikës së Maqedonisë së Veriut u nënshkrua plani bilateral në fushën e mbrojtjes në mes të Ministrisë së Mbrojtjes së Kosovës dhe Maqedonisë e

Veriut për vitin 2023. Me protokoll zyrtar, nënshkrimi i planit bilateral u bë nga drejtori i Politikave të Mbrojtjes i Ministrisë së Mbrojtjes, Faruk Geci dhe shefja e Departamentit për Bashkëpunim Ndërkombëtar, nënkolonel Biljana Nikolovska. Plani bilateral përmban

aktivitetet kryesore të fushës së mbrojtjes të cilat do të realizohen në mes të Armatës së Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe Forcës së Sigurisë së Kosovës. Të dyja palët u pajtuan që bashkëpunimi në të ardhmen të zgjerohet edhe më tej.



## Deri në tetor janë raportuar 2 287 raste të dhunës në familje

EPOKA  
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 19 DHJETOR - Këshilli për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut (KMDLNj) ka njoftuar se deri në tetor të këtij viti janë raportuar 2 287 raste të dhunës në familje. "Sipas Policisë së Kosovës, në periudhën janar - tetor 2022 janë raportuar 2 287 raste të dhunës në familje prej të cilëve femrat kanë qenë viktime në 1 799 raste, kurse meshkujt në 488 raste. Ishin edhe tri raste që përfunduan me fatalitet, të gjitha femra, e që hasën në reagim të ashpër të opinionit kosovar dhe jo vetëm në Kosovë. Numri i rasteve të raportuara në dukje është i madh, ndonëse KMDLNj vlerëson se numri i rasteve të raportuara mund të jetë edhe më i madh. Adresa e parë ku drejtohet viktime për përkrahje është Qendra për Punë Sociale që ofron ndihmën e parë dhe, në bashkëpunim me institucionet e tjera, policinë në radhë të parë, krijon mundësi për trajtim të mëtutjeshëm të viktimës", ka njoftuar KMDLNj.

Sipas këtij njoftimi, në disa raste, QPS-ja, me vetëdije apo duke u mbështetur në fakte të rreme, rreshtohet në anën e dhunuesit duke e përkeqësuar gjendjen e viktimës. "Ky vlerësim i QPS-së, bashkë me raportin e policisë, ndikon në vendimin për caktim të kujdestarisë për fëmijë (nëse kanë fëmijë), në të drejtën për trashëgimi dhe trajtimin e viktimës duke e dërguar në trajtim në institucion të mbyllur që pastaj prodhon pasoja zinxhurore për viktimën e dhunës në familje apo të ndonjë dhune në formë tjetër. Lëshimi apo dështimi i hallkës së parë të zinxhirit të trajtimit të viktimës e që është QPS-ja prodhon pasoja afatgjatë dhe, në raste të caktuara, edhe të riparueshme



për viktimën e dhunës në familje", ka njoftuar KMDLNj. KMDLNj ka dhënë vërejtje edhe për gjykatën. "Gjykata, pa e skanuar fare të kaluarën e kujdestarit që e cakton, që mund të ketë të kaluar kriminale apo probleme me ligjin, bie në lajthitje me ç'rast dhunuesi caktohet kujdestar që pastaj viktimën, përmes shantazhimit e dhunon edhe gjatë trajtimit mjekësorë sikur edhe pas trajtimit. Kujdestari i papërgjegjshëm dhe dhunues cakton se kush mund ta vizitojë viktimën gjatë trajtimit, me kë

mund të komunikojë viktime, a mund të ketë viktime telefon a jo, a do të shkojë viktime gjatë fundjavës në shtëpi apo jo ndonëse e ka lejen e mjekut, a do t'i takojë viktime fëmijët apo jo etj.etj. Me një fjalë, e mbanë viktimën në qark të izoluar duke ndikuar edhe te personeli mjekësor i cili thirret në vendimin e gjykatës si dhe në të drejtat e kujdestarit që ia njih gjykata. Edhe nëse viktime deklarohet se nuk e pranon kujdestarinë që ia cakton gjykata, vullneti i viktimës nuk respektohet edhe në kohën kur thuaja e ka gjendjen

shëndetësore të përmirësuar", theksohet në njoftimin e KMDLNj-së. KMDLNj ka kërkuar dhe kërkon një auditim të QPS-ve, raporteve të policisë, vendimeve të gjykatave sidomos në rastet që kanë të bëjnë me kujdestarinë ndaj fëmijëve, kujdestarinë ndaj viktimës, mohimin e të drejtës për trashëgimi dhe trajtimin në institucionet e mbyllura. "KMDLNj inkurajon të gjitha viktimat e dhunës në familje, të dhunës seksuale, që iu mohohet e drejta për kujdestari për fëmijët, e drejta për trashëgimi që iu

takon sipas ligjeve në fuqi, t'i raportojnë rastet në polici apo të OJQ-të që merren më të drejtat e njeriut, pa hezituar fare dhe pa pasur frikë se identiteti i tyre do të bëhet publik. KMDLNj mendon se këto raste duhet të kenë prioritet gjatë trajtimit sikur që duhet të jetë një ekip i profilizuar i avokatëve që kanë njohuri për të drejtat e njeriut e që do të merren me këto raste. Vetëm në këtë mënyrë mund të ulen rastet e dhunës në familje, si hap i parë drejt një veprimi më efikas për parandalimin e tyre!", ka njoftuar KMDLNj.

## Një qytetar nga Prizreni i gjen 850 euro, i dorëzon në polici

PRIZREN, 18 DHJETOR - Policia e Kosovës ka njoftuar se më 18 dhjetor rreth orës 20:40 një qytetar, menaxher i autolarjes vetëshërbyese "Eco Wash" në Prizren, ka gjetur një kulet me dokumente dhe para, gjithsej

850 (tetëqind e pesëdhjetë) euro. "Qytetari paratë e gjetura bashkë me dokumente i ka dorëzuar në polici. Në bazë të dokumenteve është identifikuar qytetari që i ka humbur paratë dhe është

ftuar në stacion. Pas përfundimit të procedurave administrative të njëjtit i janë kthyer paratë. Policia falënderon qytetarin në fjalë. Ky nuk është rasti i vetëm që qytetarët i kthejnë gjësendet e gjetura", ka njoftuar policia.



# Muhamet Mavraj ia uron ditëlindjen e 100-të patriotit Rexhep Balidemajt



**PRISHTINË, 19 DHJETOR-** Publicisti Muhamet Mavraj ia ka uruar ditëlindjen e 100-të veprimtarit Rexhep Balidemajt, për të cilin ka thënë se është një nga patriotët më të vjetër të mbetur gjallë.

Mavraj ka shkruar në llogarinë e vet në "Facebook" se që nga viti 1948 ka vuajtur 13 herë burgime politike kahmos nëpër Jugosllavi, duke filluar nga famëkeqi në Goli Otok. "Në fillim të vitit 1990, kur unë isha

në burg si nxënës për demonstrata, edhe ky si veteran ishte po për to. Që nga viti 1948 ka vuajtur 13 herë burgime politike kahmos nëpër Jugosllavi, duke filluar nga famëkeqi në Goli Otok. Qysh me herën e parë ia këputën karrierën kështu pilotit të parë shqiptar në Jugosllavi, aq i zoti ishte, ndonëse aq i ri. Tutje dihet rrokullisja e jetës së tij", ka shkruar Mavraj.

*Urimi i plotë i Mavrajt:*

**Të mos themi më "jetofsh 100 vjet", por më shumë!**

Ky burri këtu sot fiks 100! Është Rexhep BALIDEMAJ, një nga patriotët më të vjetër të mbetur gjallë. Në fillim të vitit 1990, kur unë isha në burg si nxënës për demonstrata, edhe ky si veteran ishte po për to. Që nga

viti 1948 ka vuajtur 13 herë burgime politike kahmos nëpër Jugosllavi, duke filluar nga famëkeqi në Goli Otok. Qysh me herën e parë ia këputën karrierën kështu pilotit të parë shqiptar në Jugosllavi, aq i zoti ishte, ndonëse aq i ri. Tutje dihet rrokullisja e jetës së tij.

Në dy dekadat e fundit jeton në Amerikë dhe sa herë vinte, burri i botës më kthehej në konak. Aq i dashur!

Baca Rexhë është një enciklopedi e gjallë ende, ka njohuri të gjithanshme. Shumë inspirues për të gjitha gjeneratat. Është një monument i gjallë patriotizmi. Ai meriton dekoratat më të larta nga të dy shtetet shqiptare dhe jo injorimin e ftohtë si hekur.

Baca Rexhë, me gjithë zemër të urojmë edhe shumë vite të lumtura!

Faleminderit që ke ekzistuar dhe faleminderit që ekziston!

## Ndahen çmimet në natën e fundit të edicionit të 15-të të Festivalit "Hyjnesha në Fron"

Festivali i filmit "Hyjnesha në Fron" shënoi edicionin e 15-të të tij. Në Kino "Armata" në Prishtinë për tre ditë me radhë janë shfaqur filma dhe janë mbajtur aktivitete artistike nga komuniteti i film-krijuesve dhe film-dashësve, përcjell KultPlus.

Festivalin "Hyjnesha në Fron" tashmë tradicional në vendin tonë, jemi mësuar të ndjekim gjatë stinës së verës por këtë edicion jubilar, të 15-tin me radhë e majti në fundvit.

Kështu publiku dhe filmdashësit patën mundësi të mbyllin vitin 2022 me shumë filma vendas e ndërkombëtar. Në këtë edicion ishin 16 filma në kategoritë filmi i shkurtër dhe filmi i gjatë.

Të dielën është shënuar ceremonia përmbyllëse e

edicionit të 15-të, ku janë ndarë çmimet:

**Filmi i metrazhit të shkurtër:**

- Filmi më i mirë : The table of the grove (Kosova);
- Regjia më e mirë : La Clé De L'amour- (Zvicra);
- Aktor/ja më i/e mirë : Mentor Zymberaj;
- Skenari më i mirë : Taking the desert;
- Hyjnesha në Fron : Kristali;
- Fotografia më e mirë : Bujar Zeqiri;

**Filmi i metrazhit të gjatë :**

- Filmi më i mirë: Internment;
- Regjia më e mirë: Kastriot Avdyli;
- Aktor/ja më i/e mirë : Klodi Hoxha
- Skenari më i mirë : Kastriot Avdyli



- Hyjnesha në Fron : Medea
- Çmimi për vepër jetësore : Selman Lokaj (me votim të komunikimit artistik).

Juria për ndarjen e çmimeve ishte e përbërë nga artistë vendas dhe ndërkombëtar (Maqedonia, Zvicra dhe Kanadaja). Pjesë e jurisë për

metrazhin e filmit të gjatë ishin : Maryam Zahirimehr, Petra Terzi, Faik Spahiu, Ilir Ajdini dhe Ilirjan Himaj. Ndërsa anëtarët e jurisë për kategorinë e filmit të metrazhit të shkurtër ishin : Jeton Zogjani, Valina Muçolli dhe Arbër Krasniqi. Çmimin "Vepër jetësore" e ndau aktori Besim Ajeti që

njëherësh është themelues i festivalit "Hyjnesha në fron" në vitin 2002.

Në këtë edicion janë shfaqur shumë projekte filmike vendore dhe ndërkombëtare por mbi të gjitha vlen të theksohet që festivali ka filluar me prodhimin e filmit. Filmit i shkurtër "N'sytë e Katës" me regji të regjisorit Shkëlzen Sylejmani – është prodhim i këtij edicionit të Festivalit "Hyjnesha në fron" që trajton temën e personave me nevoja të veçanta në kohëra lufte.

Drejtori i festivalit "Hyjnesha në fron", Enis Brahimi zotohet që festivali do të vazhdoj zhvillimin e tij edhe në vitet në vijim, ku së shpejti do të hapet edhe mundësia për aplikim në Edicionin e 16-të për vitin 2023.



# Opozita kërcënon se Projektligji i Pagave dhe ai për Zyrtarët Publikë mund të përfundojë në Kushtetuese

**PRISHTINË, 19 DHJETOR** - Pas kritikave dhe vërejtjeve, opozita ka kërkuar të hënën që mos të miratohen me nguti dy projektligjet, për Zyrtarët Publikë dhe ai për Pagat në Sektorin Publik.

Gjatë shqyrtimit të tyre mes dy leximeve në Komisionin për Administratë Publike, deputeti nga radhët e Partisë Demokratike të Kosovës, Isak Shabani, ka kërkuar që këto dy projektligje të mos miratohen me nxitim ose me procedurë të përsheptuar. "Ky nxitim ka për qëllim të miratohen me shpejtësi pa ndryshime për të përfunduar pastaj në Kushtetuese këto dy ligje. Sot nuk kemi mundur as t'i

lexojmë dhe lë më që t'i shqyrtojmë dhjetëra qindra amendamente. Kështu që duhet të na jepet kohë në mënyrë që të kemi ligje të mira", ka thënë ai.

Për këtë kryetari i komisionit nga radhët e Vetëvendosjes, Valon Ramadani, ka thënë se ka një vendim të Kuvendit për përsheptim të afateve të miratimit të këtyre dy projektligjeve.

Edhe deputeti nga AAK-ja, Besnik Tahiri, ka thënë se shqyrtimi me nguti i Kuvendit për Projektligjin për Zyrtarë Publikë dhe Projektligjin për Pagat është gabim. Tahiri ka thënë se ka propozuar një amendament për Projektligjin



për Pagat për caktimin e vlerës së koeficientit në 129 euro. Megjithatë, ai pret që punonjësit e Gjykatës dhe Prokurorisë do të jenë të


pakënaqur me Ligjin për Pagat dhe do ta dërgojnë në Kushtetuese për shkak të uljes së pagave të tyre. Ndërsa për Projektligjin për

Zyrtarët Publikë, Tahiri ka theksuar se sigurt që do të përfundojë në Kushtetuese.

Deputeti e LDK-së, Hykmete Bajrami, ka thënë se shqetësim i Zyrës së BE-së dhe LDK-së për Projektligjin për Zyrtarët Publikë mbetet shpallja e rekrutimit pas një viti për të gjitha pozitat e nivelit të mesëm menaxherial. "Në qoftë se këto shqetësime nuk do të merren parasysh, ky ligj do të përfundojë në Kushtetuese", ka thënë Bajrami.

Kuvendi në seancën e fundit ka vendosur që me procedurë të përsheptuar të shqyrtohen këto dy projektligje në lexim të dytë në seancën e së enjtes së ardhshme.

## Linja e 10 hekurudhore i kontribuon zhvillimit ekonomik dhe social



**PRISHTINË, 19 DHJETOR** - "Rehabilitimi i hekurudhës nga Fushë-Kosova e deri në Mitrovicë, edhe i paraprinë zhvillimit ekonomik, por edhe i shërben ndërlidhjes më të mirë të Kosovës me rajonin dhe me Evropën", ka thënë kryeministri Albin Kurti me rastin e fillimit të punimeve në këtë linjë hekurudhore.

Kryeministri Kurti ka theksuar se me situatën e volitshme

ekonomike dhe potencialin zhvillimor, projekte si ky i sotmi u shërbejnë nismave të qeverisë për ta rritur bashkëpunimin për zhvillim të mëtejshëm të vendit tonë. "Ky projekt do t'i kontribuojë zhvillimit ekonomik e social, hapjes së vendeve të reja të punës, avancimit të bashkëpunimit ndërfqinjësor, edhe afrimit edhe më tepër me shtetet e Bashkimit Evropian", ka thënë ai.

Kurti ka theksuar se pozita qendrore gjeografike në Ballkanin Perëndimor, infrastruktura e mirë rrugore, aeroporti modern, afërsia e porteve mesdhetare e bëjnë Kosovën vend të volitshëm tregtar dhe transportues. "Jemi duke punuar që në të ardhmen të modernizohen edhe lidhje të tjera hekurudhore, kështu që të shtohet potenciali transportues e tregtar. Kjo lidhje hekurudhore

do të rezultojë në përmirësim të kapacitetit hekurudhor si për udhëtarë, po ashtu edhe për mallra, dhe përmirësim të dukshëm edhe të kohës së udhëtimit. Do të transportojmë më shumë, do të shkojmë më shpejt. Në këtë linjë do të zhvillohet qarkullimi i trenave me një shpejtësi prej 80 km/h deri në 120 km/h. E po kaq e rëndësishme kjo lidhje do të operojë me emetime të

zvogëluara të gazrave serrë dhe të dyoksidit të karbonit", ka theksuar kryeministri.

Linja e 10 hekurudhore i përket Rrjetit Kryesor Hekurudhor të Zgjerimit të Korridoreve të Rrjetit Trans Evropian të Transportit (TEN-T).

Linja Pan-Evropiane "10" e cila fillon nga Salzburgu dhe kalon nëpër Austri, Slloveni, Kroaci, Kosovë e Maqedoni, përfundon në Selanik të Greqisë.

## Rritja e çmimeve të energjisë po ndikon në fuqinë blerëse të 85 për qind të qytetarëve të BE-së

**PRISHTINË, 19 DHJETOR** - Eurobarometer thotë se rritja e çmimeve të energjisë ka ndikuar në fuqinë blerëse të 85 për qind të qytetarëve të Bashkimit Evropian. Derisa 56 për qind besojnë se rritjet e fundit të çmimeve janë kryesisht rezultat i sjelljes agresive të Rusisë, 38 për qind nuk pajtohen.

Sipas sondazhit, 82 për qind e qytetarëve duan që BE-ja të vazhdojë të ndërmarrë veprime për ta reduktuar varësinë e saj nga karburantet

fosile ruse sa më shpejt të jetë e mundur.

Një shumicë e madhe beson se lufta ruse kundër Ukrainës i bën investimet në burimet e rinovueshme të energjisë edhe më urgjente dhe 83 për qind besojnë se çmimi i energjisë elektrike nuk duhet të varet nga çmimi i gazit. Pothuajse gjysma e të anketuarve, 49 për qind, besojnë se masat e marra nga BE-ja për përmirësimin e situatës ekonomike do të kenë ndikim pozitiv, 18 për qind se do të kenë ndikim negativ dhe

22 për qind se nuk do të kenë ndikim.

Sondazhi konfirmon se opinioni publik në BE mbetet në masë të madhe në favor të masave të marra në përgjigje të agresionit rus kundër Ukrainës. Kështu, 88 për qind mbështetin ndihmën humanitare, 71 për qind mendojnë se është mirë që BE-ja vendosi sanksione ekonomike kundër Rusisë dhe 70 për qind mbështetin mbështetjen financiare për Ukrainën.



# Pa luftën e UÇK-së nuk do të kishte Kosovë të pavarur



## Prof. asoc. dr. Ardit BIDO

Këtë konferencë po e përmbyll duke i falënderuar të gjithë ata të cilët sot janë studiues, por dje kanë qenë në ballë të betejave për të cilat ne flasim, dhe sot vijnë me një veshje të re, tashmë me një xhakë të re, që të na gëzojnë edhe për mënyrën sesi ne duhet të trajtojmë të shkuarën, jo vetëm për efekt të së shkuarës. Të shkuarën nuk e trajtojmë për thashetheme, për të diskutuar, për shkencë të thatë. E trajtojmë si një standard moral për ta parë të ardhmen, dhe besoj se kjo konferencë ia arriti këtij qëllimi. Dua ta nis duke i falënderuar në radhë të parë bashkorganizatorët: Institutin Albanologjik të Prishtinës dhe Agjencinë Shtetërore të Arkivave të Kosovës që, në fakt, janë organizatorët realë, sepse gjithmonë ndodh që kur ka bashkëpunime në qytete të ndryshme, ai që është mikpritësi, ai ka edhe barrën e organizimit. Siç tha miku im Bedriu, nisim për këtë konferencë ishte e ndërlikuar, ishte e konceptuar me një deklaratë të cilën institucionet akademike dhe kulturore e bënë në një moment shumë të rëndësishëm të historisë sonë bashkëkohore, që ishte ngritja e akuzës ndaj drejtuesve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës nga Dhoma e Specializuar të gjykatave të Kosovës që ndodhen në Hagë.

Dhe këtu dua të veçoj rolin e Bedriut, i cili ishte jo thjesht nismëtar, po edhe nxitës i fuqishëm në këtë drejtim. Na mori para dhe me të drejtë arriti ta nënshkruajë deklaratën e nëntorit 2020 si dhe ta bëjë organizimin e kësaj konference, së bashku me drejtues të tjerë të rëndësishëm institucionalë, ku dua të veçoj idenë e Skënder Gjinushit, kryetar i Akademisë së Shkencave, për ta kthyer në një tribunë akademike këtë nismë që ka një qëllim të qartë për të parë të ardhmen duke analizuar të shkuarën. Prandaj, do t'i falënderoj Institutin e Albanologjik të Prishtinës, Akademisë së Shkencave, Muzetë e dy vendeve, mikun Dorian Koçi që ndodhet këtu, veçanërisht Bedriun për nismën. Gjatë kësaj konference, pas referatit interesant dhe përmbledhës që në krye të herës të Bedri Zyberajt, i cili na tregoi tri etapat e zhvillimit të UÇK-së, patëm fatin të dëgjoni, ne dëshmitarët okularë, pos dëshminë e tij, edhe një analizë të prof. dr. Paskal Milos mbi mënyrën se si rrodhën ngjarjet në momentin crucial pak përpara dhe gjatë Konferencës së Rambujesë, pa të cilën pastaj historia nuk do të rridhte. Akademik Pëllumb Xhufin në kumtesën e tij na dha variablen e rëndësishme të parisë së UÇK-së, si një aleat partner e NATO-s, të

bashkëluftimit të NATO-s e të UÇK-së në një luftë të përbashkët, njëra nga toka, tjetra nga ajri, kuptohet njëri më i fuqishëm e tjetri më pak i fuqishëm por, ama, pa këtë që ishte më pak i fuqishëm, nuk do të ndërhynte ai që ishte i fuqishëm. Dëgjuam nga dr. Dorian Koçi arkitekturën e mundimshme të lirisë, rolin udhëheqës që kishte UÇK-ja në atë që ne sot jetojmë, si një kompromis që është Kosova e pavarur, të cilën u theksua edhe këtu që nuk ishte ky qëllimi i UÇK-së, por është kompromis i madh i shqiptarëve, ekzistenca sot e Kosovës si një shtet i pavarur me elemente të karakterit shumetnik. Dëgjuam prof. dr. Emin Kabashin mbi përmasën kombëtare të luftës së UÇK-së, mbi madhësinë e UÇK-së, veçanërisht fjalët e tij të fundit mbi vlerën e flamurit kombëtar, që edhe unë e kam një peng në fakt, që në Kosovë e shoh gjithnjë më pak e, fatmirësisht dhe lavdi Zotit, ndodhet atje ku është derdhur gjaku për atë flamur dhe e gjejmë në varrezat e dëshmorëve. Dhe le ta mbajmë këtë iluzion. Iluzioni bën keq në çastin që nuk mendojmë racionalisht, përndryshe s'është iluzion, është objektivë afatgjatë kur krijohen kushtet. Nga prof. asoc. dr. Nuri Bexheti dëgjuam një fjalim, për mua brilant, duke dhënë peshë, sepse kjo ushtri i shoi shpresat për autonomi dhe evitoi përplasjen

vëllavrasëse, të cilat sot nuk i kuptojmë ndoshta ne të rinjtë, por që ishin evidente. Do të qëndroja veçanërisht te një fjalë që çdo ditë, që pas '95-s, është një ditë e humbur, dhe çdo ditë para 2001-shit do të ishte një ditë e humbur, që na tregon dritaren e vetme, elementin e fatit se Kosova sot nuk është një Krahinë Autonome pavarësisht se do të mund të ishte nën autonomi totale brenda Serbisë. Dëgjuam prof. asoc. dr. Zaho Golemin në lidhje me drejtimin strategjik të luftës së madhe të një populli të vogël, pra në lidhje me aspektin ushtarak të kësaj lufte dhe përvojën e vet personale në këtë drejtim. Prof. dr. Lulëzim Lajçi mbajti kumtesën "Çështja e Kosovës dhe roli i diplomacisë ndërkombëtare në procesin e çlirimit të saj", me një qasje gjithëpërfshirëse, duke nisur prej fillesave të shekullit XX e duke ardhur pastaj deri në zhvillimet bashkëkohore të epopesë së UÇK-së. Dr. Albert Hitoalijaj na ftoi të gjithëve të kërkojmë më shumë në arkivat amerikane, duke na rrëfyer vlerat e rëndësishme të një syri më të paanshëm sesa ne jemi në këtë betejë të kombit tonë. Në seancën e dytë dëgjova prof. asoc. dr. Teki Kurtin, i cili kishte vendosur theksin në një prej betejave më të rëndësishme, që tregon luftën ballore që bëri UÇK-ja në betejën e Koshares, e

paraqitur kjo në këndvështrimin e shtypit shqiptar të kohës. Prof. asoc. dr. Bernard Zotaj, edhe një dëshmitar okular dhe trajnues i ditës i UÇK-së, na foli jo thjesht për përvojën e vet, por mbi baza shkencore për bazat e grumbullimit, organizimit dhe stërvitjes së UÇK-së në Shqipëri. Prof. dr. Arben Hoxha na dha një qasje filozofike në lidhje me vlerat dhe nocionin e lirisë, duke e parë UÇK-në si një masë të aftësive reflektive për bërje. Prof. dr. Minir Ademi na foli për dëshmorët e UÇK-së nga Maqedonia, sepse UÇK-ja nuk është e Kosovës. UÇK-ja është e shqiptarëve dhe duhet t'i nxjerrë në pah të gjitha momentet kur kombi ynë u bashkua për ta çliruar Kosovën nga zgjedha serbe. Prof. dr. Sali Bytyqi, duke e shtuar ndërdisiplinartitetin e kësaj konference, na dha një qasje të plotë mbi dy mënyrat e trajtimit të luftës së UÇK-së në letërsi jo për ta parë të shkuar, por për të parë të shkuar me qëllim në të ardhmen, që revizionizmin historik, që kategori të ndryshme tentojnë ta bëjnë, të mos kthehet në atë që studentët tanë sot s'e dinë çfarë ka ndodhur. Doktoresha Albulena Halili na foli për luftën e UÇK-së dhe NATO-s si një ndërmarrje e përbashkët çlirimtare përkundrajt asaj sot që padrejtësisht akuzohet. Mr. Ruzhdi Panxha foli mbi një prej momenteve që prodhoi

padrejtësi, që në hartimin e Ligjit për Arkivat, përtej gjithë arsyes së ai ligj është hartuar, që e konsideron sovranitetin e një shteti si të paplotë e që nuk mund të ketë as qasje mbi arkivat e institucioneve. Pra, mbi privimin e Arkivit të Kosovës, nga e drejta për pranimin dhe administrimin e dokumentacionit të Dhomave të Specializuara.

Prof. dr. Adem Zejnullahu na foli për një qasje tjetër ndërdisiplinore, për UÇK-në në këngët popullore. Prof. asoc. dr. Skënder Zhitija na foli për elementin e organizimit të brendshëm të UÇK-së.

Kandidati (phd) Miftar Kurti na foli në lidhje me këmbimin e robërve të luftës mes UÇK-së dhe Ushtrisë së Jugosllavisë, sipas shtypit të kohës, dhe na rrëfej se agresori dhe më së shumti agresori dhe viktimat, ndahen shumë saktë për mënyrën sesi i trajtojnë robërit e luftës të njëri-tjetrit.

E në fund, por jo për nga rëndësia, mr. Emin Sallahu na foli për UÇK-në si një domosdoshmëri e kohës sonë.

Në fund të kësaj përmblyljeje dua të theksoj se ne nuk jemi këtu për të dhënë çdo përgjigje të mundshme. Edhe po të duam, e kemi të pamundur këtë. Qëllimi ka qenë për të dhënë një mesazh në baza shkencore jo për të kaluarën, por duke parë të kaluarën për të sotmen dhe për të ardhmen. Dhe besoj se pyetja më e rëndësishme që ne shqiptarët duhet ta trajtojmë në mënyrë të vazhdueshme për brezat e rinj është: a është Kosova sot e pavarur prej fatit apo prej luftës? Nuk e kam një përgjigje të plotë për këtë pyetje. Kosova e pavarur është edhe prej fatit edhe

prej luftës, sipas gjykimit tim. Nuk dua të bëj kumtesë të re, por si përmbledhje e kësaj konference: pa shqiptarët dhe pa luftën e UÇK-së nuk do të kishte Kosovë të pavarur. Nuk po themi që ekzistenca e UÇK-së prodhoi Kosovën e pavarur, po pa të nuk do të kishte Kosovë të pavarur. Nuk është e mjaftueshme ekzistenca e UÇK-së për Kosovë të pavarur, por mungesa e UÇK-së nuk do të mund të sillte një Kosovë të pavarur. Ky është mesazhi qendror që unë pashë në të gjitha kumtesat. Padyshim se nuk do të kishte Kosovë të pavarur pa Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Nuk do të kishte Kosovë të pavarur pa NATO-n. Nuk do të kishte Kosovë të pavarur pa "rugovizmin" e viteve para '90-tave, kur çështja e Kosovës do të ngatërrohej në çështje të përgjithshme të Jugosllavisë. Vetë Millosheviqi është një aktor thelbësor për pavarësinë e Kosovës, në të zezën e vet, dhe në të zezën e kombit të vet, në kuptimin afatgjatë çfarë ia doli që të humbiste. Nuk duhet të kishte një Kosovë të pavarur pa Rusinë e dobët të asaj periudhe, dhe këtu është momenti i dyfishtë pse 2001-shi do ta bënte diferencën, sulmet terroriste në Amerikë e, nga ana tjetër, fuqizimi i ri i Rusisë. Nuk do të kishte Kosovë të pavarur pa protestat e '68-s, që prodhuan një brez të ri dhe status të ri të Kosovës. As pa protestat e '81-shit. Nuk do të kishte Kosovë të pavarur pa Mehmet Hoxhën, që mundësoi që të ekzistonin ca kufij mbi hartë, kufij të një etniteti juridik, një njësi juridike. Pa u futur në analizën e pozitives dhe negatives, po t'i

futemi gjësë së parë, çfarë do të kishte Kosovë të pavarur, s'ka pa kaçakët, s'ka pa Xhemijetin, sepse merita e kombit tonë është që edhe kur është dashur të arrinin kompromise, brezi që ka bërë këtë kompromis është një rritje. Një arritje e çdo brezi, në çastin që ka mbetur i mbyllur brenda kompromisit të vet, është ndryshuar nga një brez i ri. Ku veçohet UÇK-ja nga kjo meritë e kaçakëve, Xhemijetit e Mehmet Hoxhës, e protestave të '68-s, '81-shit e rugovizmit? Në fund është arritur kompromisi më i pranueshëm për shqiptarët, që edhe ne sot s'e kemi problem. Do të donim të mos ishin dy shtete, por Kosova e pavarur është kompromis tërësisht i pranueshëm dhe ky është produkt i UÇK-së. Pra është arritje finale, ose parafinale, por edhe kështu sikur të jetë në vijimësi, nuk është se përbën ndonjë dallim në nevojën tonë, dhe këtu UÇK-ja veçohet. Pra pa UÇK-në s'do të kishte një shtet të Kosovës sot, një Kosovë të pavarur, me vetë UÇK-në. Vetëm me UÇK-në prapë s'do të kishte. Është lufta e shqiptarëve, plus fati që na kanë mundësuar këtë gjë.

E nisëm këtë konferencë me idenë dhe me nismën e Bedriut, çfarë ndodhi me Hashim Thaçin, Kadri Veselin, Jakup Krasniqin, Rexhep Selimin, të cilët janë katër individë që janë bashkëkohës me ne. Shumë prej jush i njihni personalisht, i keni miq. Të tjerë jo. Shumë prej jush i doni politikisht. Të tjerë jo. Ajo që na bashkon është se nuk na interesojnë Thaçi, Krasniqi, Veseli, Selimi. Ajo që duhet t'i bashkojë të gjithë shqiptarët është se nuk janë ven-

dosur përballë akuzës thjesht këta individë, se po të jetë se janë katër individë përballë akuzës për korrupsion, do të ketë njerëz që do t'i duan, do të ketë njerëz që s'do t'i duan dhe nuk na interesonin në planin afatgjatë. Nëse do të ishte se do të ishin atje për krime lufte të kryera vetë, shkenca nuk do të binte në kurthin e pyetjes, a ka pasur krime lufte nga të gjitha palët në luftë?! Është kurth! Është kurth relativizues!

Hashim Thaçi, Kadri Veseli, Jakup Krasniqi, Rexhep Selimi ndodhen nën akuzë si drejtues politikë të UÇK-së. E nëse drejtimi politik i UÇK-së qenka kriminal, thjesht pse është drejtues politik, jo doras, atëherë i bie që kemi të bëjmë me një agresor, i bie që UÇK-ja është agresore. Në çastin që zëdhënësi i UÇK-së është përballë tribunalit, se luante rolin e zëdhënësit të UÇK-së, e jo se ishte doras në një krim dhe, nga ana tjetër, zëdhënësi i agresorit është Shkëlqesia e tij, president i një vendi, atëherë këtu ka një padrejtësi. Ka një padrejtësi që në misionin fillestar, prandaj jemi sot këtu.

Dua ta përmbyll me një përvojë personale. Nuk e them këtë me sens modestie. Si një i ri Sarandë, një kalama dhjetë 12 vjeç në vitin '99, kur refugjatët e Kosovës arritën deri në Sarandë, lufta e Kosovës edhe na njohu me realitetin e viteve '90-2000. Identiteti u fluidizua pak në Shqipëri, jo se nacionalizmi folklorik nuk qëndronte, jo se në Sarandë ishim më pak nacionalistë sesa janë sot apo sesa ishim pardje, por në kuptimin e një relativizimi kulturor të një ndikimi të huaj që ishte më i pasur dhe nga sytë i kishim të

gjithë, e nga ana tjetër nga paradigmat e vjetra, të përçarjeve krahinore fetare, që i kemi shumë për qejf si komb, d.m.th. "malokët e veriut, të trashët e jugut". Kur e thotë një lab këtë "maloku i Fushë-Kosovës", ku të shkosh në Labëri është zakon, pothuaj kush është malok apo jo. Pra në këtë paradigmë të vitit '99, ardhja e refugjatëve të Kosovës kontribuoi edhe në një gjë: kontribuoi që për herë të parë unë kam parë aq shumë flamuj në Sarandë. Jo se kishte flamuj grekë ndonjëherë në Sarandë, jo se kishte më pak nacionalizëm aty, por ata flamuj shqiptarë dhe rritjen e një identiteti të ri të fortë na sollti lufta e Kosovës dhe refugjatët. Atëkohë u njohëm me një brez të ri. Dhe kjo ka shumë rëndësi. Prandaj, besoj se kjo konferencë është shumë e rëndësishme dhe dua ta falënderoj secilin, veçanërisht Bedriun në radhë të parë. Më falni që e veçoj. Ne shqiptarët do të duhet ta shohim të shkuarën me mendjeftohtësi për të parë të ardhmen.

Së fundmi, një kërkesë për të gjithë ju: kumtesat t'i dorëzoni deri në fund të prillit, në mënyrë që të gjitha këto që u thanë sot, të jenë të shkruara dhe të mbeten në letër, me shpresën e madhe që do të kemi mundësi të vijojmë me konferenca të tjera të tilla, të kësaj cilësie, pikërisht me të njëjtin synim, sesi do të veprojmë ne si shqiptarë në vitin 2022 e tutje.

Faleminderit shumë!

Fjalë përmblylëse për sesionin shkencor "Ushtria Çlirimtare e Kosovës, vlerë kombëtare"



# Skandali më i madh i korrupsionit në historinë e sportit



**Nga Alessandro CAPPELLI**

Parimi i salçipes thotë se nëse kemi përpara diçka të mirë apo të bukur, është më mirë të mos e dimë se si është bërë ajo. Zakonisht kjo vlen për ligjet dhe politikën: më mirë të mos investigosh se çfarë fshihet pas marrëveshjeve, kompromiseve dhe shtrëngimeve të duarve. Por mesa duket kjo vlen edhe për botën e futbollit, dhe konkretisht për FIFA-n. Për një kohë të gjatë tifozët dhe spektatorët e thjeshtë i injoruan, zgjedhën që të mos u jepnin rëndësi skandaleve në lidhje me qeverisjen e futbollit, edhe kur ishin në qendër të lajmeve sëkronikës së zezë. Tek e fundit, nëse pjata është e mirë, është mirë të mos bëni shumë pyetje sesi është gatuar ajo. Megjithatë, fillimi i botërorit të Katar ndryshoi çdo perspektivë. Faktet skandaloze që në fillim u përhapën në rrjetet sociale dhe më pas në media, e kanë zbehur interesin për ngjarjen më të rëndësishme futbollistike, duke e varrosur bukurinë sportive të kompeticionit nën një mal kalbësie, korrupsioni dhe vdekjes të pandëshkuara. Katar është përgatitur për gati 2 dekada për këtë botëror, dhe nuk ka arritur të ofrojë ende një organizim të krahasueshëm me edicionet e mëparshme. Nga ana tjetër FIFA, duket se ka bërë ciklin e plotë, në fund të një rruge dhe të një rënijeje politike, por edhe morale dhe njerëzore, e cila i ka rrënjët që shumë kohë më parë.

“Në rast se doni ta menaxhoni FIFA-n me një kod etik, atëherë duhet të keni shumë fat!” -thotë Zherom Valcke, ish-sekretari i përgjithshëm i FIFA-s, në pjesën e fundit të dokumentarit të Netflix-it “FIFA:Zbulimi i gjithë skandaleve”. Në 4 episode, seriali i publikuar pak para fillimit të Kupës së Botës, paraqet një panoramë të frikshme: 4 orë intervista me gazetarë, ish-zyrtarë të FIFA-s, agjentë sportivë, hetues dhe njerëz të përfshirë në hetime, janë një përzierje shkeljesh ligjore dhe neverie, që e bëjnë rrëfimin e një historie futbollit, një seri mbi perversionin kriminal të pushtetit, dhe mbi pashmangshmërinë e së keqes. “Unë nuk jam i sigurt nëse është e mundur të ndiqet një kod etik në këtë institucion” - thotë Valcke, me një përzierje të vetëbesimit dhe pranimit të pangushëllueshëm të realitetit. Për dekada me radhë, FIFA kishte qenë vetëm një organizatore aktivitetesh sportive me një vizion thjesht idealist të një futbollit jofitimprurës, dhe me qëllimin përfundimtar për të shfaqur para botës lojën e bukur. Në vitin 1974 kreu i FIFA-s u bë Zhoao Havelanzh. Ishte viti në të cilin nisi të zbehej ideja romantike e organit drejtues të futbollit botëror: fushata elektorale e ish-notarit brazilian ishte ambicioze. Ai foli për një futboll të përhapur global, për një flamur në çdo pëllëmbë të hartës së botës. Politikisht ishte një strategji e shkëlqyer. Në një sistem në të cilin


çdo federatë kombëtare vlen një votë, organizatat kontinentale të Amerikës së Veriut (CONCACAF) dhe Afrikës (CAF) do të kishin një peshë të madhe në votë, pavarësisht se kishin tregje marginale në lidhje me lëvizjen botërore të futbollit. Por për të siguruar vazhdimësinë në detyrë, ai duhet të bindte drejtuesit e atyre federatave. Dhe sukcesi i Havelanzh filloi pikërisht me zarfet me para që do t'u shpërndaheshin presidentëve të federatave, të cilëve do t'u kërkojë votën: është momenti historik në të cilin korrupsioni në FIFA shndërrohet në një element sistematik, shtylla mbi të cilën mbështetej pushteti. Një vizion që nuk mund të materializohet me burimet e pakta të një organizate, që deri atëherë ishte e krahasueshme me një OKB të futbollit. Pra futbollit duhej të vdiste, i zëvendësuar nga një vizion i lojës si produkt, si një mall për t'u shitur pas ofertën më të mirë. Fytyra dhe mendja prapa këtij transformimi ishte një zviceran me origjinë nga Visp, njëqytetëz me 7 mijë banorë në luginat e Kantonit Valais. Një njeri i dashuruar pas futbollit që mezi priste të kishte një rol në këtë histori. Ishin hapat e parë në ndërtimin e një perandorie, të cilën që Sep Blater do ta sundonte më pas për shumë vite. Ideja ishte revolucionare, por shumë e thjeshtë: duheshin sponsorë. Dhe i pari është kompania Coca Cola, që në vitin

1976 u bë partnere në projektet e futbollit për të rinjtë. “Dy organizata të mëdha mund dhe duhej të kishin punuar së bashku” -mendon Blater. Por duhej një furnizues i pajisjeve sportive, dhe kompania e dytë e njohur me të cilën u firmos marrëveshje ishte ADIDAS. Më pas do të pasojnë marrëveshjet e tjera me Phillips, Canon, Gillette. Nëse ka një shpërblim, cilido mund të organizojë Kupën e Botës. Havelanzh mbështet ofertën e Argentinës për organizimin e Kupës së Botës së vitit 1978. Kjo do të thoshte të shpërbleje Videlën dhe juntën e tij ushtarake, por nga pikëpamja e futbollit si produkt, gjithçka u vendos në plan të dytë. Ato mund të duken si histori të një të kaluarë më të errët se e tashmja. Në realitet gjithçka është ende aty, sikur disa parime të ishin gdhendur në gur. Të dielën e kaluar presidenti aktual i FIFA-s, Xhani Infantino – që fatkeqësisht u la jashtë dokumentarëve të Netflix, por që vitet e fundit ka shtrënguar dorën me Vladimir Putin dhe sheikët e Katarit – tha se çdokush mund të presë Kupën e Botës, madje edhe Koreja e Veriut. Pjesa kryesore shfaqet në episodin e tretë, dhe ka të bëjë më akuzat për korrupsion të anëtarëve të FIFA-s nga Katar, dhe me kryqëzimin mes futbollit dhe interesave geopolitike, të cilën e nxitën Blaterin ta shpallte me njëfarë hezitimi vendin e vogël të Gjirit si organizatoren e botërorit të këtij viti. Informatorja Fedra Almaxhid, shefe

e marrëdhënieve me mediat ndërkombëtare në FIFA, zbulon se ishte dëshmitare e rryshfeteve të dhëna në këmbim të votave për Katarin. Hasan AlTauadi, Sekretari i Përgjithshëm i Komitetit Suprem përgjegjës këtë botëror, u ofroi para delegatëve nga Kameruni (Isa Hajatu), Bregu i Fildishtë (Zhak Anuma) dhe Nigeria (Amos Adamu) për të siguruar votën e tyre. Skandali duket shumë më real dhe më mizor këto ditë, kur lojtarët më të mirë në botë po dalin të luajnë në stadiumet që ndodhen në mesin e shkretëtirës, mes tifozëve të remë dhe menjë ndjenje të përgjithshme “se gjithçka është e rreme, shumë, shumë e rreme”, siç tha për Linkiesta agjenti i një lojtari, që preferon të mbetet anonim dhe që zbarkoi në Katar dy ditë para ndeshjes hapëse. Hetimi i FBI-së çoi në vitin 2015 në ngritjen e 47 akuzave, përfshirë ato të mashtrimit dhe pastrimit të parave; në arrestimin e 7 drejtuesve të lartë; vënien në hetim të 4 anëtarëve të Komitetit Ekzekutiv; dhe dorëheqjen e Sepp Blater. Departamenti i Drejtësisë i Shteteve të Bashkuara – që koordinoi hetimet me FBI-në – e kishte përcaktuar atë si një rrjet të dendur korrupsioni të lidhur që kishte ndikuar në marrëveshjet e marketingut, të drejtave televizive dhe në përcaktimin e organizatorëve të Kupës së Botës, për shifra që arrijnë në qindra miliona dollarë, gjatë një periudhe kohore prej rreth 2 dekadash. / “Linkiesta” – Bota.al

**EURO GLASS**  
SAINT-GOBAIN  
SEKURIT  
PILKINGTON  
Enveri

Adr: Fushë Kosovë  
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336  
E-mail: euro.glass@live.com




QENDRA SPORTIVE  
'BUJQËSIA'  
TEL: 045/82 82 82

## Fillon afati kalimtar në basketboll

PRISHTINË, 19 DHJETOR - Federata e Basketbollit e Kosovës (FBK) ka njoftuar se afati kalimtar për klubet e Prince Caffè Superligës ka filluar të hënën (19 dhjetor). Afati kalimtar do të zgjasë deri

më 21 dhjetor. Ky afat pritet të jetë mjaft interesant, me disa basketbollistë që pritet të ndërrojnë klube, ndërsa garat në elitë janë bërë shumë interesante. "Basketbollistët

kosovarë mund të bëjnë ndryshime të skuadrave deri më 21 dhjetor, kurse skuadrat mund t'i regjistrojnë basketbollistët e huaj 72 orë para javës së 22-të", thuhet në

njoftimin e FBK-së. Stinori pranveror pritet të sjellë spektakël, duke marrë parasysh synimet e skuadrave dhe ndeshjet interesante që po zhvillohen.



# Tetë finalet e Messit me Argjentinën

DOHA, 19 DHJETOR - Në thelb mbaroi ashtu siç filloi. Finalja e parë me Argjentinën, Leo Messi luan në Utrecht. Është 2 korriku 2005, akti i fundit i një Botërori U-20, aty ku ai ngre trofeun e parë me kombëtaren, për më tepër me dy gola të tij. Shuplaka e parë nuk harrohet kurrë, në finale kundër Brazilit, Messi humb mundësinë e parë për të triumfuar në Kupën e Amerikës. Argjentina pëson tre gola nga rivali i përjetshëm. Por një vit më vonë, fati i buzëqesh në Lojërat Olimpikë të Pekinit, dhe hakmarrja pikërisht në finale ndaj Brazilit në shifrat 3-0. Zhgënjimi më i madh do të vinte në vitin 2014, Messi shpallet më i miri i Botërorit të Brazilit, por nuk ngre dot Kupën e Botës. Një vit më pas, Messi shfaqet në Kili për Kupën e Amerikës dhe humbet sërish,

madje si kapiten. Ai arriti në finale kundër skuadrës vendase, nuk pati gola, nga penalltitë Argjentina dështon. Nuk mbaron këtu tersi i keq me finalet e Kupës së Amerikës së Jugut. Në vitin 2016 përsëri në finale kundër Kilit dhe sërish Argjentina gabon në 11-metërshat pas rezultatatit 0-0. Messi tërhiqet nga kombëtarja dhe duket se reflektimi për t'u rikthyer i solli fat. Leo thyen tabunë me Argjentinën në Rio de Janeiro më 10 korrik 2021 si golashënuesi më i mirë, duke mposhtur Brazilin në shtëpinë e tij dhe triumfon në Kupën e Amerikës. Për të ardhur te mbrëmja e 18 dhjetorit, ku edhe pse shënon dy gola, u desh të vuante shumë për ta ngritur lart Kupën e Botës, duke kompletuar koleksionin e artë të trofeve.



## Prishtina nënshkruan kontratë me talentin Amar Demolli



PRISHTINË, 19 DHJETOR - FC Prishtina ka nënshkruar kontratë me futbollistin e talentuar Amar Demolli. 16-vjeçari është produkt i Shkollës së Futbollit "Kurda", që njihet si "çerdhe" e talenteve, shkollë e cila drejtohet nga zbuluesi i madh i futbollistëve të talentuar, Mehmet Kurda. Demolli të hënën nën shoqërinë e babait të tij, Nuredinit dhe trajnerit Mehmet Kurda ka firmosur kontratë me Klubin e Prishtinës. Talenti prishtinas është edhe reprezentues i Kosovës U-17, përfaqësues me të cilën ka luajtur edhe në kualifikimet e fundit për Kampionatin Evropian. Amari u prezantua në klub nga drejtori sportiv Driton Krasniqi. Skuadra kryeqytetase arriti që ta rekrutojë në radhët e saj një futbollist të talentuar e

bashkëpunimi me trajnerin Mehmet Kurda do të vazhdojë edhe në të ardhmen. Pas nënshkrimit të kontratës, Amari tashmë si futbollist i Prishtinës i pa nga afër ambientet e stadiumit "Fadil Vokrri" derisa pozoi me fanellën "bardhekaltër" edhe në fushën e gjelbër. "Është privilegj shumë i madh që të jem pjesë e Prishtinës. Jam shumë i lumtur dhe premtoj se do ta jap maksimumin tim në fanellën 'bardhekaltër'. Do ta bëj më të mirën time në stërvitje në mënyrë që të zë vend edhe në përbërje. Me punë mund të arrihet çdo gjë", ka thënë Demolli, i cili ka bërë edhe një premtim për tifozët. "Tifozëve u premtoj se do t'i bëj të lumtur me paraqitjet e mia. Shpresoj se me rezultatet tona do të kënaqen pas çdo sfide", ka deklaruar Demolli.

## Benzema pensionohet nga kombëtarja

MADRID, 19 DHJETOR - Karim Benzema është pensionuar nga Kombëtarja franceze e futbollit. Sulmuesi i Real Madridit e ka dhënë lajmin nëpërmjet llogarisë së tij në rrjetet sociale.

"Kam bërë përpjekjet dhe gabimet e nevojshme për të qenë këtu ku jam sot dhe jam krenar për këtë! Unë kam shkruar historinë time dhe e jona po mbaron", ka shkruar

Benzema. 34-vjeçari gjatë karrierës së tij ka regjistruar 97 ndeshje për Francën duke kontribuar me 37 gola. Ky vendim i Karim Benzemas vjen vetëm një ditë pasi Franca u

mposht në finale të Kupës së Botës nga Argjentina. Benzema nuk ishte pjesë e reprezentacionit francez në këtë Botëror për shkak të një lëndimi.



## Pele uron Messin për Kupën e Botës: Maradona po buzëqesh nga qielli

SAO PAOLO, 19 DHJETOR - Ikona e Brazilit, Pele, ka uruar Messin dhe Argjentinën pas fitores së tyre dramatike me penallti kundër Francës në finalen e Kupës së Botës Katar 2022. Argjentina dhe Franca i mbyllën

120 minutat me rezultatin 3-3, por nga goditjet e penalltive më pas, Messi ngrii në qiell trofeun që i mungonte. "Sot futbolli vazhdon ta tregojë historinë e tij, si gjithmonë, në një mënyrë magjepsëse. Leo Messi fitoi

Botërorin e tij të parë ashtu siç e meritonte për karrierën e tij. Miku im i dashur Mbappe shënoi katër gola në një finale. Sa dhuratë ishte të shikoje këtë shfaqje, të ardhmen e sportit tonë. Dhe nuk mund të mos

përgëzoja Marokun për turneun e jashtëzakonshëm. Është e mrekullueshme ta shohësh Afrikën të shkëlqejë. Urime Argjentinë! Sigurisht që Diego Maradona po buzëqesh tani", thuhet në letrën e Peles.



## Këto janë përfitimet e kombëtareve që morën pjesë në Botëror

Doha, 19 dhjetor - Të dielën përfundoi Kampionati Botëror i futbollit me Argjentinën që u kurorëzua si më e mira në botë pasi mposhti Francën pas ekzekutimit të penalltive. Përtej prestigjit që ofron pjesëmarrja në këtë kampionat, kombëtalet marrin edhe përfitime monetare që ndahen sipas suksesit të arritur. Argjentina merr më shumë para nga çdo ekip, por nuk merr



### Ja sa merr çdo skuadër për Kupën e Botës 2022:

Kampionia (Argjentina): 42 milionë dollarë

Nënkampioni (Franca): 30 milionë dollarë

Vendi i tretë: (Kroacia): 27 milionë dollarë

Vendi i katërt: (Maroku): 25 milionë dollarë

Vendi 5-8 (Holanda, Brazili, Portugalia dhe Anglia): 17 milionë dollarë secila

Vendi 9-16 (SHBA, Australia, Polonia, Senegali, Japonia, Koreja e Jugut, Spanja dhe Zvicra): 14 milionë dollarë secila

Ekipet e fazës së grupeve (Ekuadori, Katari, Irani, Uells, Meksika, Arabia Saudite, Tunizia, Danimarka, Gjermania, Kosta Rika, Belgjika, Kanadaja, Kameruni, Serbia, Uruguai dhe Gana): 9 milionë dollarë secila.

shumicën e parave që ndahen. Sa fiton secili ekip varet nga mënyra se si e përfunduan turneun, plus një shtesë prej 1.5 milion dollarësh që ndahen për secilin për kostot e përgatitjes. Pavarësisht prej humbjes në finale, Franca merr 30 milionë dollarë. Vendi i tretë, Kroacia, merr 27 milionë dollarë dhe i katërti, Maroku, merr 25 milionë dollarë.

## Brooklyni me gjashtë fitore radhazi synon kreun, fitojnë edhe lakersat e Denveri

DETROIT, 19 DHJETOR - Skuadra e Brooklyn Netsit është në një moment pozitiv në NBA, derisa ka arritur fitoren e gjashtë radhazi. Ajo fitoi me rezultat 124-121 ndaj Detroitit jashtë fushës, në një ndeshje me shumë rivalitet. Durant me 43 pikë e Irvingu me 38 pikë praktikisht mposhtën të vetëm Detroitin, duke bërë ligjin në fushë. Jashtë fushës fiton edhe skuadra kampione e Golden States, që mundi me shifrat 126-110 Toronton. Jordan Poole me 43 pikë ishte lider në fushë për Warriors, duke i dhënë fitoren



ekipit të tij. Fitorja e shtatë radhazi për New Yorkun që, gjithashtu, po kalon një moment të mirë. Nju-jorkezët fituan me rezultat 109-106 ndaj Indianas (Bronson 30 pikë më i miri). Lakersat i afrohen zonës "play-off" pas fitores 119-117 ndaj Washingtonit, ndeshje

ku të gjithë titullarët e ekipit kalifornian realizuan mbi 10 pikë (LeBron Jamesi me 33 pikë më i miri). Denveri, falë "triple double" të Nikola Jokiqit (40 pikë, 27 rebounde e 10 asistime), mundi me shifrat 119-115 Charlotten dhe synon kreun në Perëndim.

### REZULTATET

Boston - Orlando	92-95
Indiana - New York	106-109
Detroit - Brooklyn	121-124
Toronto - Golden State	110-126
Minnesota - Chicago	150-126
Denver - Charlotte	119-115
Lakers - Washington	119-117

## Wolff paralajmëron rivalët: Do t'i kujtoni me nostalgji ditët pa Mercedes protagonist

Shefi i Mercedesit, Toto Wolff, ka reaguar për sezonin e fundit dhe ka paralajmëruar rivalët për atë që i pret vitin tjetër. Ai beson se makina gjermane do të jetë protagoniste dhe

sezonin e kaluar ka qenë një leksion shumë i mirë, që u shërben për vitin 2023. "Mendoj se për t'u ngjitur në majë duhet fillimisht të gabosh apo të dështosh. Nuk ka asnjë

skuadër që i ka fituar të gjitha titujt kampionë ku ka marrë pjesë. Ndaj leksioni që morëm këtë vit ishte i fortë dhe personalisht mësova shumë, duke njohur pikat e forta e të

dobëta të skuadrës", ka thënë Wolff. "Di të them që sezonin tjetër do të jemi aty, duke dueluar për titullin, duke qenë protagonistë. Ditët kur Mercedesi zhgënjente do të

jenë larg, një nostalgji për rivalët tanë, që do të na shohin ndryshe në pistë. Shpresoj shumë që e ardhmja ta vërtetojë këtë që po them", u shpreh Wolff.

### SHKURT

#### Gjashtë skuadra të interesuara për Ardon Jasharin

Mesfushori i talentuar shqiptar, Ardon Jashari, ka pasur një vit të jashtëzakonshëm, ku bëri debutimin me ekipin e parë të Luzernit, pastaj mori edhe ftesën për Kupën e Botës "Katar 2022". Por ka shumë mundësi që ai mos të luajë më për Luzernin, ku është kapiten i këtij klubi, pasi ofertat në drejtim të klubit zviceran për shqiptarin ka me bollëk. 20-vjeçari ka zhvilluar 15 ndeshje në Superligën e Zvicrës, ku ka bërë edhe katër asistime. Megjithatë, mediet zvicerane kanë raportuar se janë plot gjashtë skuadra që duan transferimin e shqiptarit gjatë afatit kalimtar të janarit. Lideri aktual i Ligës Premierë, Arsenali, është në krye të listës, derisa në Angli reprezentuesi zviceran pëlqehet edhe nga Leicester City. Interesim për talentin me prejardhje nga Kumanova ka shprehur edhe lideri aktual i Serisë A, Napoli.

#### Berisha i pakënaqur te Torino, afër kalimit te Salernitana

Portieri i kombëtares shqiptare, Etrit Berisha, pritet të largohet nga Torino gjatë merkatos së janarit, për t'u transferuar te rivalët e Salernitanas. Lajmi është konfirmuar sot nga "tuttomercatoweb", që zbulon edhe detajet e këtij transferimi. Skuadra e Salernitanas do të pagujë 1 milion euro për ta marrë 100% kartonin e portierit kuqezi. Berisha ka ende dy vjet e gjysmë kontratë me skuadrën e Torinos, por është i pakënaqur, pasi nuk është aktivizuar shumë këtë sezon. "Skuadra e Salernitanas është në kërkim të një portieri pas dëmtimit të Sepe, që do të qëndrojë gjatë jashtë fushave të lojës. Për pasojë, Berisha është emri i duhur për ta zëvendësuar, pasi meriton të vijojë të luajë në Serinë A", ka thënë Federico Pastorello, menaxheri i Berishës.

#### Mbappe: Ne do të kthehemi

Franca pësoi humbje në finale të Kupës së Botës derisa lojtari francez ka reaguar për herë të parë pas kësaj humbje. Sulmuesi ka thënë se Franca do të rikthehet: "Ne do të kthehemi". Mbappe u shpall golashënuesi më i mirë i Botërorit, me tetë gola të shënuara.

#### Ancelotti: Oferta e Brazilit? Ndihem mirë në Real

Brazili ka mbetur pa trajner pas largimit të Tites, kurse mediet kanë raportuar se drejtimin e kësaj kombëtare mund ta marrë Carlo Ancelotti, aktualisht trajner i Real Madridit. Ai nuk e ka përjashtuar mundësinë që një ditë të jetë trajner i Brazilit, por ka konfirmuar se ndihet mirë në Real dhe se nuk e ka ndër mend të largohet. "Të drejtoj Brazilin? Nuk e di të ardhmen, jetoj nga dita në ditë. Jam i lumtur dhe ndihem mirë këtu, kemi ende shumë synime për të arritur. Ka kohë për të menduar për të ardhmen. Kam një kontratë që përfundon në vitin 2024 dhe nëse Reali nuk më largon, nuk do të largohem", ka thënë Ancelotti.



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**

*Qeveria –Vlada-Government*  
**MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCES DHE TEKNOLOGJISË**  
AGJENCIA PËR ARSIM DHE AFTËSIM PROFESIONAL DHE ARSIM PËR TË RRITUR  
AGENCIA ZA PROFESIONALNO OBRAZOVANJE I OSPOSOBLAVANJE I OBRAZOVANJE ZA ODRASLE  
AGENCY FOR VOCATIONAL EDUCATION AND TRAINING AND ADULT EDUCATION

Nr. 1168/22  
Dt. 19.12.2022

## KONKURS

### PËR REGJISTRIMIN E NXËNËSVE PËR VITIN SHKOLLOR 2022/2023, KLASËT E 10-ta PËR VIJUES NË ARSIMIN E MESËM TË LARTË PROFESIONAL – MESIMI PËR TË RRITUR

Për plotësimin e vendeve të lira për regjistrimin e nxënësve në klasën e dhjetë (10) në Q.K. “11 Marsi” në Prizren, **shpallim këto drejtime:**

<b>I. Makineri</b>		
1	Instalues i Ngrohjes dhe Klimatizimit	1 Paralele 24 nxënës
2	Instalues i Ujësjellësit dhe Kanalizimit	1 Paralele 24 nxënës
3	Automekanik	1 Paralele 24 nxënës
4	Dizajn i Metaleve	1 Paralele 24 nxënës
<b>II. Ndërtimtari</b>		
1	Arkitekturë	1 Paralele 24 nxënës
2	Ndërtimtari	1 Paralele 24 nxënës
3	Dizajn Enterier	1 Paralele 24 nxënës
<b>III. Artet e aplikuara</b>		
1	Dizajn Veshje	1 Paralele 24 nxënës
2	Dizajn Grafik	1 Paralele 24 nxënës
<b>IV. TRANSPORT</b>		
1	Transport Rrugor	1 Paralele 24 nxënës
<b>V. Elektroteknikë</b>		
1	TIT	1 Paralele 24 nxënës
2	Informatikë	1 Paralele 24 nxënës
3	Instalues Elektrik	1 Paralele 24 nxënës

#### 1. Kushtet e përgjithshme për regjistrimin e nxënësve të rregullt

Për regjistrimin e nxënësve në klasën e 10-të, për vijimin e mësimin për të rritur në shkolla profesionale, për vitin shkollor 2022/2023, mund të konkurrojnë kandidatët të cilët e kanë mbaruar arsimin e obligueshëm dhe që janë më të vjetër se 17 vjeç.

Nxënësit, të cilët e kanë mbaruar klasën e 9-të jashtë Kosovës, obligohen ta bëjnë nostrifikimin e dëftesave në MASHT dhe pastaj të konkurrojnë për regjistrim.

#### 2. Dokumentet e nevojshme për konkurrim

Nxënësit për të konkurruar për regjistrim në klasën e 10-të shkollave profesionale, duhet të paraqesin këto dokumente:

Fletëparaqitjen (e cila merret në shkollën në të cilën konkurron)  
Dëftesën origjinale për kryerjen e shkollës së mesme të ulët (6-9) dhe Certifikatën e lindjes.

#### 1. Afati i paraqitjes së dokumenteve dhe shpallja e rezultateve

Paraqitja e dokumenteve, bëhet 15 ditë nga dita e shpalljes. Dorëzimi i dokumenteve bëhet në lokalet e shkollës Q.K. “11 Marsi” në Prizren, nga ora 10:00-14:00.



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**

*Qeveria –Vlada-Government*  
**MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCES DHE TEKNOLOGJISË**  
AGJENCIA PËR ARSIM DHE AFTËSIM PROFESIONAL DHE ARSIM PËR TË RRITUR  
AGENCIA ZA PROFESIONALNO OBRAZOVANJE I OSPOSOBLAVANJE I OBRAZOVANJE ZA ODRASLE  
AGENCY FOR VOCATIONAL EDUCATION AND TRAINING AND ADULT EDUCATION

Nr. 150/2022  
Dt. 19.12.2022

## KONKURS

### PËR REGJISTRIMIN E NXËNËSVE PËR VITIN SHKOLLOR 2022/2023, KLASËT E 10-ta PËR VIJUES NË ARSIMIN E MESËM TË LARTË PROFESIONAL – MESIMI PËR TË RRITUR

Për plotësimin e vendeve të lira për regjistrimin e nxënësve në klasën e dhjetë (10) në Qendren e Kompetenes në Prizren, **shpallim këto drejtime:**

<b>I. Ekonomi</b>		
1	Nepunes Industrie	1 Paralele 24 nxënës
<b>II. Tregti</b>		
1	Sherbimet ndaj konsumatorit	1 Paralele 24 nxënës
<b>III. Turizem</b>		
1	Asistent ne organizimin e eventeve	1 Paralele 24 nxënës

#### 1. Kushtet e përgjithshme për regjistrimin e nxënësve të rregullt

Për regjistrimin e nxënësve në klasën e 10-të, për vijimin e mësimin për të rritur në shkolla profesionale, për vitin shkollor 2022/2023, mund të konkurrojnë kandidatët të cilët e kanë mbaruar arsimin e obligueshëm dhe që janë më të vjetër se 19 vjeç.

Nxënësit, të cilët e kanë mbaruar klasën e 9-të jashtë Kosovës, obligohen ta bëjnë nostrifikimin e dëftesave në MASHT dhe pastaj të konkurrojnë për regjistrim.

#### 2. Dokumentet e nevojshme për konkurrim

Nxënësit për të konkurruar për regjistrim në klasën e 10-të shkollave profesionale, duhet të paraqesin këto dokumente:

Fletëparaqitjen (e cila merret në shkollën në të cilën konkurron)  
Dëftesën origjinale për kryerjen e shkollës së mesme të ulët (6-9) dhe Certifikatën e lindjes.

#### 1. Afati i paraqitjes së dokumenteve dhe shpallja e rezultateve

Paraqitja e dokumenteve, bëhet 15 ditë nga dita e shpalljes. Dorëzimi i dokumenteve bëhet në lokalet e shkollës Qendren e Kompetenes në Prizren, nga ora 10:00-14:00.



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo  
Qeveria - Vlada - Government

Trepça Shoqëri Aksionare  
Trepça Deonikarsko Društvo / Trepça Joint Stock Company



Duke u bazuar në Rregulloren për dhënie me qira të pronës së paluajtshme të Trepçës Sh.A. me numër protokoll 119 date 11.01.2021, divizioni i shitjes dhe qirasë me datën 19.12.2022 bënë shpallje publike:

#### NJOFTIM PËR DHËNE KONTRATËS: T-22-08

Qëllimi i ofertës: Dhënie me qira e zyrës në Terminalin doganore dhe deponë në Metalurgjinë e Zinkut.  
Kriteret e Dhënies: Çmimi më i lartë  
Numri i ofertave të pranuar: 1 (njëzet)

#### ME KONTRATË SHPËRBLEHET

Loti 1 Zyre 17 çmimi për m<sup>2</sup> 11.00 € pa TVSH – UNI – Trade shpk

Kontratat janë paraparë të nënshkruhet me datën 26.12.2022 ora 10:00

#### NJOFTIM PËR ANULIM : T-22-08

Lot 2 Anulohen për shkak të mos pranimit të asnjë oferte:

#### AUTORITETIT KONTRAKTUES (AK)

Emri zyrtarë: Trepça sh.a.		
Adresa postare: Parku inustrial		
Qyteti: Mitrovicë	Kodi postarë: 40000	Shteti: Kosovë
Kontakti: Burim HAJDINI		Telefoni: +383 (0) 28 538 050
Email: sales@trepcacorporation.com		Faksi: +383 (0) 28 539 202
www.trepcacorporation.com		

Çdo palë e interesuar mund të bëjë ankesë pranë Autoritetit Kontraktues, në bazë të nenit 14 të Rregulloren për dhënie me qira të pronës së paluajtshme të Trepçës Sh.A. me numër protokoll 119 date 11.01.2021.



# Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punës
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



facebook

[www.facebook.com/gjejpuneshpejte](http://www.facebook.com/gjejpuneshpejte)

## RESTAURANT

# SWISS TAVERNA

Tel: +377 45 400 156

+386 49 848 553

PRISHTINË

**Lume's Details**  
Estetik & Depilim

044 900 978 | 045 687 898

Sallon Depilimi Lume's Details

lumesdetails

Mbrapa Teatrit, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi

### >> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Marigona Prenaj nga Gajkova shpall të pavlefshme dëftesën e kl. X,XI,XII,XIII dhe diplomën e Sh.Mjekësisë "Hysni Zajmi" Infermeri.

- Marigona Prenaj nga Gjakova shpall të pavlefshme certifikatën për kryrjen e arsimit profesional të SH.M.të mjekësisë "Hysni Zajmi" Gjakovë.

- "Admaria" SH.P.K. shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me nr. 811870204.

- Infermierja e përgjithshme, Rabe Nikçi nga komuna Pejës me numër personal 1003700182, shpalli të humbur Licencën e Punës me numër: KO-3462-05-20, me afat prej 03.01.2018 deri 03.01.2023.

- Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.

- Urgjentisht kërkoj një banesë me qera në Prishtinë. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188

- Lëshoj lokalin më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit:049-392-275

- Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanët me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.





ROYAL CROWN  
**RC**  
cola

## ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

### Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

**RC**  
cola  
Columbus, Georgia, USA  
Since 1908

**RC**  
cola  
Columbus, Georgia, USA  
Since 1908  
0.5L